**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

**FAKULTETI I BIZNESIT**

**DEPARTAMENTI I FINANCË KONTABILITETIT**

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**"Bankë-Financë "**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Jonida Lamçja (Koordinatori i programit të studimit)
2. Selma Kaçaniku (Lektore e Departamentit të Financë Kontabilitetit)
3. Enida Istrefi (Lektore e Departamentit të Financë Kontabilitetit)
4. Heriona Korriku (Përfaqësues Biznesi)
5. Kleandi Lika (Student që i përket programit të studimit)
6. Spiro Paço (Koordinatori Institucional i IAL pranë ASCAL)
7. Marsida Dyrmishi (Përfaqësuese e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë)

Mars 2023

*Parathënie për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm*

## PARIMET E PUNËS SË GVB

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tabllo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.
- Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të kryhet sipas formatit të hartuar nga ASCAL, duke mos bërë asnjë lloj ndryshimi (psh. Bashkim kriteresh, heqje kriteresh, etj.).

## ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit.

- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA.
- Njoftohet zyrtarisht Koordinatori i IAL, për fillimin e procesit të akreditimit, dhe caktohet data e takimit me të për diskutimin e hapave të procesit.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm; ky grup ngrihet nga titullari i njësisë;
- Trainimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkese;

- Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV);
- Dorëzimi zyrtarisht në ASCAL brenda afatit të përcaktuar (në versionin e printuar dhe elektronik CD, firmosur / vulosur nga IAL në çdo faqe), materialet të ngarkohen edhe në sistemin AMS të ASCAL.

**DOSJA E VETËVLERËSIMIT**

Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit përfshihet: *Mendimi me shkrim i Drejtuesit të Njësisë* dhe *Raporti i Vlerësimit të Brendshëm,* i shkruar dhe firmosur nga secili anëtar i GVB.

Kërkohet mendimi i drejtuesit të Njësisë, kur Programi i studimit po kalon fazën e rivlerësimit periodik. Në këtë rast ai do të shkruajë:

- Të dhëna për Institucionin e Arsimit të Lartë që ai drejton;
- Të japë opinionet e veta personale ku të tregohen vlerat e forta, dobësitë dhe perspektiva e programit të studimit për të cilën është përgjegjës;
- Të analizojë zhvillimet kryesore që nga vlerësimi i fundit, duke theksuar sidomos përmbushjen e detyrave të lëna nga vlerësimet e mëparshme;
- Të tregojë gjendjen ekzistuese në raport me atë programi/et e studimit, ka për mision ose synon të arrijë.

**PËRMBAJTJA DOSJES SË VETËVLERËSIMIT**

Dosja e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit të programit të studimit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Mendimi me shkrim i Drejtuesit të IAL (Universitetit/Fakultetit);
2. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i firmosur nga të gjithë anëtarët e GVB. RVB përbëhet nga 6 fusha për programet e ciklit të parë Bachelor.
3. Çdo fushë duhet të analizojë kërkesat e standardid / kritereve, duke përfshirë pjesën përshkrimore dhe duke dhënë tregues të matshëm, bazuar në evidencat e dosjes së vetvlerësimit.
4. Bazuar në këtë analizë GVB duhet të përcaktojë vlerësimin përfundimtar të përmbushjes së standardeve të çdo fushe, dhe fushës në tërësi.
5. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë edhe analizën përfundimtare të institucionit duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tij.

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

*Përshkrimi i Programit Bsc. Bankë-Financë*

Zhvillimet në sektorin bankar dhe atë financiar po ecin me ritme shumë të shpejta, të cilat e vendosin biznesin/institucionin në situata komplekse. Programi Bachelor në "Bankë-Financë" ofron një bazë të gjërë njohurish për ti aftësuar studentët që të vlerësojnë projektet e investimeve me anë të teknikave të ndryshme. Ky program përmban informacione të detajuara përsa i përket vendimeve financiare të marra nga individët/bizneset/institucionet dhe përdorimin e njohurive për të mbledhur fonde në tregjet e parasë dhe kapitalit. Megjithëse është një nga disiplinat më të vjetra në botë, Financa dhe Banka mbetet një nga degët më të njohura, sepse nuk kalon asnjë ditë pa marrë vendime të vogla apo të mëdha financiare. Individët dhe organizatat për të arritur qëllimet e tyre fitimprurëse ndihmohen nga profesionistë të bankave dhe të financave nëpërmjet menaxhimit të parave dhe të pasurive financiare. Nëpërmjet këtij programi Bachelor Bankë-Financë ofrohet një pamje e përgjithshme e tregjeve, ekonomisë dhe e biznesit. Një karrierë në këtë fushë ofron bazën për një gamë të gjerë karriere si në banka, ndërmjetësim, këshillim apo sigurime. Sektori i shërbimeve financiare përfshin investimet, sigurimet, rishpërndarjen e rrezikut dhe operacione të tjera financiare, ndërsa industria bankare fokusohet më së shumti në kursimet direkte dhe kreditimin.

Banka dhe Financa eksplorojnë botën dinamike dhe me ritme të shpejta të parave, aksioneve, kredisë dhe investimeve. Financa është një pjesë thelbësore e ekonomisë sonë pasi siguron likuiditetin në terma të parave ose aktiveve të nevojshme për individët dhe bizneset për të investuar për të ardhmen. Studentët që zgjedhin të diplomohen në Bachelor Bankë-Financë, do të mësojnë të eksplorojnë lëvizjen dhe menaxhimin e sistemuar të parave. Në firma, funksioni i financës siguron që aktivitetet të financohen me kapital ose borxh dhe firmat mund të zgjedhin projektin e rritjes së vlerës dhe të menaxhojnë flukset monetare, rrezikun dhe likuiditetin në interes të palëve të tyre të interesit.

| TË DHENA MBI INSTITUCIONIN<br>UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU, DURRËS | | | |
|---|---|---|---|
| **Të dhënat për aktet themelore** | **Lloji i Aktit (VKM/Urdhër)** | **Nr.** | **Datë** |
| Leja për fillimin e veprimtarisë | Vendim | 801 | 20.12.2005 |
| Licencimi i institucionit | K61829504T | 20061800004 | 29.06.2006 |
| Akreditimi i institucionit | Vendim | 10 | 07.04.2017 |
| Hapja/riorganizimi i njësisë kryesore ku ofrohet programi | Vendim | 685 | 25.08.2010 |

| INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT | |
|---|---|
| Fakulteti që ofron programin e studimit: | Fakulteti i Biznesit |
| Departamenti që ofron programin e studimit: | Departamenti i Financë Kontabilitetit |
| Emërtimi i programit të studimit: | "Bankë-Financë" |
| Cikli i studimeve | Niveli I |
| Lloji i programit | Bachelor i brendshëm (organizuar nga Institucioni) |
| Totali i Krediteve (ECTS) | 180 ECTS |

| | |
|---|---|
| Kohëzgjatja normale në vite | 3 vite |
| Forma e studimit | Studime me kohë të plotë |
| Gjuha e studimit | Shqip |
| Programi ofrohet nga institucioni | Po |
| Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Jo |
| Diplomë e përbashkët | Jo |
| Diplomë e dyfishtë | Jo |
| Niveli në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve | Niveli 6 (gjashtë) |
| Vendimi i Ministrisë së Arsimit dhe e Shkencës | Nr. 1786 Prot. 20.03.2007 |
| Vendimi i Këshillit të Ministrave për Riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës | VKM Nr.685, datë 25.08.2010 |

Programi Bachelor në "Bankë-Financë" ka si qëllim kryesor të përgatisë profesionistë me kualifikimin e duhur dhe me njohuritë e mjaftueshme në fushën e financës dhe bankave. Objektivat kryesore mbi të cilat mbështetet ky program studimi janë:

- Përgatitja e profesionistëve të aftë të kuptojnë, të analizojnë dhe ti paraprijnë zhvillimeve të shpejta të sektorit bankar dhe financiar.
- Zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme për të vlerësuar dhe hartuar raporte ekonomike dhe financiare të çdo lloj subjekti qoftë ai publik apo privat.
- Aftësimi i studentëve për të vlerësuar sistemet financiare në dimension ndërkombëtar.
- Zhvillimi i aftësive për aplikimin e teknikave të duhura të menaxhimit të rrezikut.
- Aftësimi i studentëve në njohjen e strukturës së tregjeve financiare, të palëve që përfshihen në to, të instrumentave financiarë që tregtohen si dhe ndikimeve të transaksioneve të ndryshme që zhvillohen në këto tregje.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

-Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
-Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.
-Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tabllo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për proçesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve.
-Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
-Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
-Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, proçedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.

*Përshkrimi i Grupit të vlerësimit të brendshëm*

-Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Këshilli i Akreditimit.
-Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL.
-Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, i cili ngrihet nga titullari i njësisë, me vendim nr. 7, datë 7/02/2023.
-Trajnimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
-Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas manualit të ASCAL. Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë dhe ASCAL.
-Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave e udhëzimeve në manualin e ASCAL dhe pas konsultimit të përmbajtjes së tij me stafin e njësisë.
-Dorëzimi në ASCAL i RVB në afatet e përcaktuara.

RVB përbëhet nga *6 rubrika kryesore*. Çdo rubrikë ka standartet dhe kriteret perkatëse të secilës rubrikë që kërkohet të analizohet. Në pjesën e vlerësimit cilësor sipas standardeve GVB-ja është përgjigjur konkretisht për çdo kriter dhe për çdo standard, nëse plotësohet apo jo dhe specifikisht evidencat përkatëse. Raporti Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë vlerësimin e GVB për këto çështje:

I. Ofrimi i Programeve të Studimit
II. Organizimi, Drejtimi dhe Administrimi i Programeve të Studimit të Ciklit të parë Bachelor
III. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat
IV. Burimet Njerëzore, Financiare, Infrastruktura, Logjistika për Realizimin e Programit të Studimit
V. Studentët dhe mbështetja e tyre
VI. Sigurimi i Cilësisë së Programeve të studimit Bachelor

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë

## Bachelor në "Bankë-Financë "

# I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

**Standardi I.1**
**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përp uthje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse pë r programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.**

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu, Durrës" (UAMD), i krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 801 datë 20.12.2005[1], riorganizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 685, datë 25.08.2010[2], akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 10, datë 07.04.2017[3,4]. Aktualisht UAMD është akredituar institucionalisht për një periudhë 4 vjeçare[5]. UAMD është një institucion i arsimit të lartë që ushtron veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe administrative. *Referuar nenit 3 të Statutit të Universitetit*[6], misioni i UAMD mbështetet në parimin se arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike. Misioni i UAMD-së është në pajtueshmëri të plotë me vizionin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026[7]. Duke ofruar programe studimi të cilat janë në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës, edukimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | **Po.** Programi i studimit të nivelit të parë "Bankë-Financë" i ofruar nga Fakulteti i Biznesit, UAMD është hartuar në harmoni me qëllimet dhe misionin e UAMD-së. Referuar nenit 4 të Statutit të Universitetit, pika 3/a, b[8], *Universiteti ka për qëllim:*<br>*a) Të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar e ndërkombëtar të punës.*<br>*b) Të formojë shkencëtarë të rinj, nëpërmjet punës kërkimore-shkencore të nivelit më të lartë bashkëkohor.*<br>Gjithashtu duhet theksuar që veprimtaria e universitetit organizohet dhe realizohet përmes njësive të tij përbërëse (*Referuar nenit 7, pika 1 të Statutit të Universitetit)*[9], ku Fakulteti i Biznesit është pjesë përbërëse e universitetit (*Referuar nenit 10, pika 1 dhe 2 të Rregullores së UAMD-së)* [10]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | **Po.** Programi i studimit "Bankë-Financë" është në përputhje me synimet dhe misionin e institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të UAMD. Një ndër prioritetet dhe objektivat kryesore të institucionit është investimi në cilësinë e mësimdhënies, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare (*Referuar pikës IV të Planit të zhvillimit strategjik 2020 – 2025 të UAMD-së*)[11], [12].<br>UAMD në përputhje me politikat dhe objektivat e tij, harton programe dhe projekte kërkimore shkencore specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme. Ai konkurron me këto projekte në planin kombëtar për financimin e kërkimit shkencor, teknologjik |

[1] Evidencë 1. VKM nr. 801 datë 20.12.2005 "Për hapjen e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës
[2] Evidencë 2. VKM nr. 685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"
[3] Evidencë 3. Vendim nr. 10 datë 07.04.2017 i Bordit të akreditimit "Për akreditimin e parë të institucionit të arsimit të lartë "Universiteti Aleksandër Moisiu" Durrës"
[4] Evidencë 4. Raporti i Vlerësimit Institucional të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës 2016
[5] Evidencë 5. Vendimi nr 18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit dhe Raporti i Vlerësimit Institucional
[6] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[7] Evidencë 7. Vendim nr. 621, date 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit për zbatimin e saj
[8] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[9] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[10] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[11] Evidencë 9. Plani i Zhvillimit Strategjik 2020 – 2025 të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[12] Evidencë 10. Planifikimi i Veprimtarive Strategjike 2021-2023 të Universitetit "Aleksandër Moisu", Durrës

| | |
|---|---|
| | dhe kulturor, si dhe në planin ndërkombëtar (*Referuar nenit 7, pika 1 të Statutit të Universitetit*)[13]. Programet e studimit të ofruara janë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit janë të identifikuara në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar (*Referuar pikës IV të Planit të zhvillimit strategjik 2020 – 2025 të UAMD-së*)[14]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | **Po.** Kapacitetet infrastrukturore verifikohen çdo fillim viti akademik nga Ministria përgjegjëse për Arsimin e Lartë gjatë miratimit të kuotave[15] për çdo program studimi, gjithashtu duhet theksuar që këto kërkesa monitorohen në mënyrë të vazhdueshme edhe nga komisioni i përhershëm për garantimin e standardeve dhe cilësisë (*Referuar nenit 20, pika 5b të Rregullores së UAMD-së*)[16](*Referuar Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë*)[17] UAMD ka të gjitha kapacitetet e nevojshme, qoftë në burime njerëzore[18, 19, 20, 21] por edhe në infrastrukturën[22] e vënë në dispozicion për të ofruar një shërbim sa më cilësor për studentët të cilët kanë zgjedhur të studiojnë pranë këtij institucioni. |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | **Po.** Programet e studimit që ofrohen nga UAMD janë në përputhje me misionin e UAMD-së si dhe misionin e Fakultetit të Biznesit. Fusha e studimit të programit bachelor "Bankë-Financë" ka përputhshmëri me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore (FB) e cila është përgjegjëse për programin e studimit. Përputhja e programit të studimit me misionin e Fakultetit të Biznesit dhe UAMD-së realizohet që në momentin e aplikimit të hapjes së programit të studimit, fillimisht nga Departamenti i Financë Kontabilitetit, më pas nga Fakulteti i Biznesit dhe më pas nga Senati Akademik.<br>Ky program studimi i ciklit të parë (niveli 6 i Kornizës shqiptare të Kualifikimeve (KSHK))[23] është riorganizuar në masën nën 20% edhe në vitin 2021[24].<br>Për sa i përket kodifikimit kombëtar të programeve të studimit (*Referuar nenit 86, pika 4 të Ligjit nr. 80/2015*)[25],[26].<br>UAMD ka kërkuar propozime për kodifikimin e programeve të studimit[27], [28], Departamenti i Financë Kontabilitetit ka kodifikuar programet e ofruara pranë tij (*Referuar Shkresës për kodifikimin e programeve të Departamentit të Financë Kontabilitetit*)[29]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

[13] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[14] Evidencë 9. Plani i Zhvillimit Strategjik 2020 – 2025 të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[15] Evidencë 11. Memo "Kuotat e pranimit të studentëve për të tre nivelet e studimit për Departamentit Financë Kontabilitet, Viti Akademik 2021-2022 dhe 2022-2023"
[16] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[17] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[18] Evidencë 14. Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisu
[19] Evidencë 15. Statistika me tabela
[20] Evidencë 16. Organigrama e Departamentit të Financë Kontabilitetit
[21] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[22] Evidencë 17. Planimetria e Fakultetit të Biznesit
[23] Evidencë 18. Nivelet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) https://akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/NIVELET-E-KORNIZÃ%E2%80%8B9S-SHQIPTARE-TÃ%E2%80%8B9-KUALIFIKIMEVE.pdf
[24] Evidencë 19. Vendim i Senatit Akademik nr. 20 dt 30.03.2021 për "Riorganizimin nën 20% të programit të studimit bachelor "Bankë-Financë".
[25] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[26] Evidencë 21. Vendim nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[27] Evidencë 95. Kërkesë për propozime të kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga UAMD
[28] Evidencë 114. Udhëzim nr. 31, datë 15.11.2022 për "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
[29] Evidencë 117. Shkresë për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | **Po.** UAMD ka parashikuar mënyrën e funksionimit, ndarjen e detyrave dhe bashkëpunimin mes njësive përbërës organike të tij[30]. Çdo njësi përbërëse ka detyra dhe objektiva, ku njësitë bazë organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore dhe njësitë kryesore koordinojnë aktivitetet e njësive bazë që ata përfaqësojnë (*Referuar Statutit të Universitetit*[31]). Njësitë e tjera janë struktura të krijuara nga Universiteti në përputhje me misionin dhe veprimtarinë e institucionit të cilat ndihmojnë në përmbushjen e misionit të Universitetit (*Referuar Rregullores së UAMD-së)* [32].<br>Në përmbushje të këtij misioni institucioni siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ndërmjet përgjegjësit të grupit mësimor e kërkimor (*Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit, neni 23, pika 4 (a, b, c, d))*[33], përgjegjësit të departamentit (*Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit, neni 21, pika 3 (ç))*[34] dhe zëvendës dekanit (*Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit, neni 19, pika 4)*[35].<br>Në kuadër të mbarëvajtjes dhe ecurisë së punës për programn e studimit "Financë Kontabilitet", bëhen analiza të vazhdueshme në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Biznesit (*Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit, neni 23, pika 4 (dh))*[36], (*Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit, neni 21, pika 4)*[37], (*Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit, neni 20, pika 6 (b))*[38]. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | **Po.** UAMD ka prioritet zhvillimin e politikave bashkëpunuese, përdorimin me efektivitet të marrëveshjeve ekzistuese mbi praktikat e studentëve dhe arritja e marrëveshjeve të reja që synojnë krijimin e lidhjeve reale me tregun e punës me qëllim punësimin e mundshëm të tyre si dhe krijimin e një mekanizmi ndërlidhës efektiv e të drejtpërdrejtë të Zyrës së Karrierës dhe Alumni me departamentet e ndryshme të universitetit (*Referuar pikës IV të Planit të zhvillimit strategjik 2020 – 2025 të UAMD-së)*[39].<br>Departamenti i Financë Kontabilitetit angazhohet për të siguruar marrëveshje me institucione si Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Doganave, ISKSH, ALSA, Dhoma e Tregtisë, Kompanitë e Sigurimit dhe Institucione të tjera financiare banka dhe jo banka, partnerë sipërmarrës si biznese private, kontabilistë të miratuar, ekspertë kontabël të regjistruar etj. me qëllim përmbushjen sa më të mirë të veprimtarisë mësimore për aftësimin praktik të studentëve (*Referuar angazhimit nr. 5 në Planin Strategjik të Departamentit Financë Kontabilitet 2021-2025)*[40] |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, | **Po.** UAMD ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me Universitete partnere brenda dhe jashtë vendit, si dhe me institucione të tjera ku vend të rëndësishëm zënë njësitë ekonomike dhe kompanitë e biznesit[41,42]. Objekti kryesor i këtyre |

[30] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[31] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[32] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[33] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[34] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[35] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[36] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[37] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[38] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[39] Evidencë 9. Plani i Zhvillimit Strategjik 2020 – 2025 të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[40] Evidencë 23. Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025
[41] Evidencë 24. Lista e marrëveshjeve në nivel Institucional të UAMD
[42] Evidencë 67. Raport mbi ecurinë e bashkëpunimeve Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë

| | |
|---|---|
| kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | marrëveshjeve është ndërtimi i kapaciteteve, shkëmbimi i burimeve njerëzore, hartimin e programeve të reja të studimit, realizimin e praktikave mësimore, etj. Ndër kontributet më të rëndësishme të marrëveshjeve të bashkëpunimit është lehtësimi i tranzicionit të studentëve nga studimi në tregun e punës. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | **Po.** Njësia përgjegjëse për programin e studimit ka hartuar Raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit[43], [44] të zyrtarizuara me institucionin, ku të diplomuarit[45] rezultojnë të jenë punësuar nga këto marrëveshje[46]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

**Standardi II.1**
**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.**

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | **Po.** UAMD në vitin 2018, në funksion të kërkesave të implementimit të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"[47] si dhe në zbatim të udhëzimit nr. 31 dt. 29.12.2017 të MASR[48] ka riorganizuar të gjitha kurrikulat e ofruara në këtë institucion (përfshirë edhe programin e studimit "Bankë-Financë", në ciklin e parë të studimeve bachelor[49, 50, 51]. Ky program studim është riorganizuar në funksion të përmirësimit të tij edhe në vitin 2021[52]. Riorganizimet janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi (*Referuar Kreut IV të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[53] *i ndryshuar)*[54], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[55], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[56], [57]. |

[43] Evidencë 70. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit Departamenti i Financë Kontabilitetit
[44] Evidencë 67. Raport mbi ecurinë e bashkëpunimeve_Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me jashtë
[45] Evidencë 25. Punësimet e studentëve të diplomuar
[46] Evidencë 69. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti
[47] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[48] Evidencë 27. Udhëzimi nr. 31 dt. 29.12.2017
[49] Evidencë 28. Vendim nr. 1 dt. 25.01.2018 i Rektoratit të UAMD
[50] Evidencë 29. Vendim i Senatit Akademik, UAMD nr. 98 dt. 14.06.2018 për Riorganizimin e programit të studimit bachelor "Bankë-Financë"
[51] Evidencë 31. Riorganizimi i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë", viti 2018
[52] Evidencë 19. Vendim i Senatit Akademik nr. 20 dt 30.03.2021 për "Riorganizimin nën 20% të programit të studimit bachelor "Bankë-Financë".
[53] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[54] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[55] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[56] Evidencë 112. VKM nr.879, datë 18.12.2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.01.2018
[57] Evidencë 130. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018

| | |
|---|---|
| | Programit i studimit bachelor "Bankë-Financë" është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar në 180 kredite, sipas sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të krediteve (ECTS) (*Referuar kurrikulës së programit të Studimit*)[58]. Kohëzgjatja normale e tyre është tre vite akademike me kohë të plotë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë universitare "Bachelor". Ky program studimi zhvillohet në gjuhën shqipe (*Referuar nenin 36 i Rregullores së Fakultetit të Biznesit*)[59]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | **Po.** Programi i studimit synon/ndihmon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh mbështetur (*Referuar raportit "Studimi periodik për tregun e punës pas diplomimit të studentëve"*)[60] dhe *mbështetur në pikën II/2 të Riorganizimit të Programit të studimit*[61], ky program studimi ka objektiva plotësisht të qarta, të arritshme në shërbim të kualifikimit të nevojshëm me kërkesat e tregut të punës. Ky program studimi ka objektiva plotësisht të qarta duke krijuar baza të qëndrueshme njohurish për studimet të mëtejshme, Master Shkencor etj. Rritja e kompetencave profesionale është ndër elementët kryesorë në këtë program studimi. Përdorimi i literaturave të viteve të fundit, kërkime shkencore, raste studimore të cilat realizohen nga përmirësimi i vazhdueshëm i syllabus-ave. Gjithashtu për tju përshtatur diversitetit të kërkesave të studentëve, lektorët mundohen të sjellin metoda nga më inovativet të ofruara tek studentet[62] me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | **Po.** Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite, të organizuara në kategoritë A, B, C, D dhe E të cilat janë të ndërthurura, të detyrueshme dhe me zgjedhje (*Referuar Planit mësimor/kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë -Financë "*)[63]. Përbëja e strukturës së programit të studimit është përcaktuar në akte ligjore e nënligjore (*Referuar Kreut IV të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[64] *i ndryshuar)*[65], *(Referuar pikës 2.5 të VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[66], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[67]. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | **Po.** Programi i studimit[68] është i përbërë nga veprimtari formuese (A-E), ku në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuse si dhe praktika profesionale, ndërsa në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim (*Referuar pikës 2.5 dhe Shtojcës nr. 1, tabela 1 të VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[69], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[70], *(Referuar nenit 19 dhe 20 rregullores së programit të studimit)*[71], *(Referuar Rregullores së Diplomimit)*[72] |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe | **Po.** Departamenti i Financë Kontabilitetit i propozon njësisë bazë kriteret dhe procedurat për pranimin në programet e studimit[73], [74], të cilat miratohen nga Senati |

[58] Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
[59] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[60] Evidencë 33. Studimi për ecurinë e programit të studimit
[61] Evidencë 31. Riorganizimi i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë", viti 2018
[62] Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[63] Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
[64] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[65] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[66] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[67] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[68] Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
[69] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[70] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[71] Evidencë 32. Rregullore e programit tëstudimit Bachelor "Bankë- Financë"
[72] Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[73] Evidencë 37. Memo "Kriteret e pranimit të studentëve për të tre nivelet e studimit për Dep. Financë Kontabilitet. Viti Akademik 2022-2023"
[74] Evidencë 92. Memo "Kriteret e pranimit të studentëëve për të tre nivelet e studimit për Dep. Financë Kontabilitet. Viti Akademik 2023-2024"

| | |
|---|---|
| financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Akademik[75]. Në kuotat e pranimit parashikohen edhe kuota për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare, me status jetimi si dhe personat me aftësi të veçanta.<br>Në përmbushje të misionit të UAMD-së për të siguruar një ambjent suportues që mbështet pjesmarrjen dhe fuqizimin e çdo studenti, institucioni për tiu ardhur në ndihmë studentëve me aftësi të kufizuar ka krijuar një Njësi Shërbimi për Aftësinë e Kufizuar pranë Zyrës së Kujdesit ndaj Studentëve (*Referuar Rregullores për Studentët me aftësi të kufizuara*) [76]. Në godinat e UAMD-së është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme për të lehtësuar lëvizjen e tyre.<br>Institucioni harton dhe zbaton në përputhje me aktet ligjore[77, 78] përkatëse procedurën për pranimin e dokumentacionit përkatës dhe miratimin e studentëve të cilët përfitojnë nga ky kriter. Studentët e kategorive sociale të veçanta përfitojnë bursë në masën 100% ose 50%[79, 80]. |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | **Po.** Referuar nenit 86, pika 2 të Ligjit nr. 80/2015[81] Programi i studimit bachelor "Bankë-Financë" ka përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70% me programet që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe në të njëjtën emërtesë (*Referuar Programeve të studimit të ciklit të parë, të fushës së studimit "Bankë-Financë " të ofruara nga universitetet brenda vendit*)[82] |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | **Po.** Referuar Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj, realizimi i kodifikimit të programeve të studimit, në zbatim të nenit 86, pika 4 të Ligjit për Arsimin e Lartë[83], parashikohej të niste nga MAS në TM2-2023[84], bazuar VKM nr. 310, date 11.5.2022[85].<br>UAMD ka kërkuar propozime për kodifikimin e programeve të studimit[86], [87], ku Departamenti i Financë Kontabilitetit ka kodifikuar programet e ofruara pranë tij (*Referuar Shkresës për kodifikimin e programeve të Departamentit të Financë Kontabilitetit*)[88]. |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | **Po.** Programi i studimit "Bankë-Financë " nuk është program i përbashkët me institucion tjetër të arsimit të lartë, vendas apo të huaj. Ky program studimi ofrohet vetëm nga Fakulteti i Bisnesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|

[75] Evidencë 38. Vendimet për përcaktimin e kritereve të pranimit të studentëve në UAMD – Viti Akademik 2022-2023
[76] Evidencë 39. Rregullore për studentët me aftësi të kufizuar
[77] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[78] Evidencë 40. VKM nr. 903, datë 21.12.2016 të ndryshuar me VKM nr. 450, datë 22.5.2017; nr. 697, datë 21.11.2018; nr. 39, datë 23.1.2019; nr. 755, datë 30.11.2019
[79] Evidencë 41. Vendim i Bordit të Administrimit nr. 3, datë 18.2.2022 https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2019/03/vendimi-3.pdf
[80] Evidencë 42. Vendim i Bordit të Administrimit nr. 5, datë 18.2.2022 https://www.uamd.edu.al/wp-content/uploads/2019/03/vendimi-5.pdf
[81] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[82] Evidencë 43. Programe studimit të ciklit të parë, të fushës së studimit "Bankë-Financë" të ofruara nga universitetet e tjera
[83] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[84] Evidencë 7. Vendim nr. 621, date 22.10.2021 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit për zbatimin e saj"
[85] Evidencë 21.Vendim nr. 310, datë 11.5.2022 "Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[86] Evidencë 95. Kërkesë për propozime të kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga UAMD
[87] Evidencë 114. Udhëzim nr. 31, datë 15.11.2022 për "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
[88] Evidencë 117. Shkresë për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Financë Kontabilitetit

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | **Po.** UAMD në mbështetje të dispozitave ligjore[89] si dhe në zbatim të misionit dhe qëllimeve e objektivave të saj, është e organizuar në njësi kryesore (fakultetet), njësi bazë (Departamentet/qendrat kërkimore) si dhe njësi të tjera (laboratorët)[90]. Çdo Fakultet ka së paku 3 njësi bazë (*Referuar nenit 23, pika 2 të Ligjit nr. 80/2015*)[91]. Fakulteti i Biznesit ka në përbërje të tij 5 departamente[92]: Departamenti i Financë Kontabilitetit, Departamenti i Menaxhimit, Departamenti i Shkencave Ekonomike, Departamenti i Marketingut dhe Departamenti i Turizmit. Secili departament ka në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada e tituj (*Referuar nenit 25, pika 4 të Ligjit nr. 80/2015*)[93].<br>Departamenti i Financë Kontabilitetit ka në përbërje të tij 16 anëtarë[94], nga të cilët 1 anëtar mban titullin Profesor, 1 anëtar mban titullin Profesor i asocuar, 9 janë Doktor Shkencash, 2 Doktorantë (në IAL të huaja) dhe 3 në proçes doktorature në UAMD.<br>UAMD në mënyrë të vazhdueshme vlerëson[95] cilësinë e mësimdhënies (*Referuar nenit 6 të Rregullores së NjSCB*)[96] dhe akreditimit (*Referuar nenit 17-19 të Rregullores së NjSCB*)[97]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | **Po.** UAMD ka të punësuar personel ndihmës-akademik me karakter akademik (laborantë) 10 persona, personel ndihmës akademik me karakter administrativ 44 persona dhe personel administrativ 183 persona. Në fakultetin e Biznesit janë të punësuar 70 personel akademik me kohë të plotë dhe personel ndihmës akademik me kohë të plotë me karakter akademik (laborantë) 2 dhe me karakter administrativ 10 persona.<br>Fakulteti i Biznesit përmbush të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për angazhimin e personelit akademik ndihmës/administrativ për realizimin e programit bachelor "Bankë-Financë"[98].<br>Përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit është drejtuesi i njësisë bazë dhe kordinatori i programit, gjithashtu njësia kryesore mbështet stafin akademik në zhvillimin e programit përmes sekretarisë mësimore dhe laborantëve. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit | **Po.** Departamenti i Financë Kontabilitetit përgjegjës për programin e studimit ka caktuar një lektor në rolin e koordinatorit të programit të studimit[99] (*Referuar nenit 11 të Rregullores së NjSCB*)[100], i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale dhe përcaktimin e Koordinatorit për Kërkimin Shkencor[101]. |

---

[89] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[90] Evidencë 14. Organigrama e Universitetit Aleksandër Moisiu
[91] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[92] Evidencë 15. Statistika me tabela
[93] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[94] Evidencë 16. Organigrama e Departamentit të Financë Kontabilitetit
[95] Evidencë 45. Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit
[96] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[97] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[98] Evidencë 46. Udhezimi i MASR nr. 27 dt 29.12.2017
[99] Evidencë 52. Memo për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
[100] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[101] Evidencë 51. Vendimi i përcaktimit të kordinatorit të kërkimit shkencor

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | ✓ |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | **Po.** Njësia bazë Financë Kontabilitet, përgjegjëse për programin e studimit, disponon dosjen e plotë të programit të studimit bachelor Bankë-Financë[102]. Dosja përmban informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Programi i studimit është organizuar dhe strukturuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi (*Referuar VKM 41, pika 2.4 dhe 2.5)*[103] dhe *(Kreu III i Udhëzimit nr.31 datë 29.12.2017)*[104]. Ky program studimi është riorganizuar në funksion të përmirësimit të tij edhe në vitin 2021[105]. Riorganizimet janë kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi (*Referuar Kreut IV të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[106] *i ndryshuar)*[107], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[108], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[109]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | **Po.** Dosja e programit të studimit[110, 111] përmban planin mësimor, të ndarë në semestra, ngarkesën mësimore për secilën lëndë dhe orët brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me akte ligjore e nënligjore në fuqi (*Referuar Kreut IV të Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[112] *i ndryshuar)*[113], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[114], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[115]. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | **Po.** Departamenti i Financë Kontabilitetit për çdo vit akademik i përcjell njësisë kryesore kriteret dhe procedurat për pranimin në programet e studimit[116],[117] , të cilat miratohen nga Senati Akademik[118]. Kriteret e pranimit bëhen publike në faqen zyrtare të Universitetit[119].<br>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e transferimit dhe ekuivalentimin e studimeve (*Referuar Rregullores* |

[102] Evidencë 31. Riorganizimi i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë", viti 2018
[103] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[104] Evidencë 27. Udhëzimi nr. 31 dt. 29.12.2017
[105] Evidencë 19. Vendim i Senatit Akademik nr. 20 dt 30.03.2021 për "Riorganizimin nën 20% të programit të studimit bachelor "Bankë-Financë".
[106] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[107] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[108] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[109] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[110] Evidencë 31. Riorganizimi i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë", viti 2018
[111] Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
[112] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[113] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[114] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[115] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[116] Evidencë 37. Memo "Kriteret e pranimit të studentëve për të tre nivelet e studimit për Dep. Financë Kontabilitet, Viti Akademik 2022-2023"
[117] Evidencë 92. Memo "Kriteret e pranimit të studentëve për të tre nivelet e studimit për Dep. Financë Kontabilitet, Viti Akademik 2023-2024"
[118] Evidencë 38. Vendimet për përcaktimin e kritereve të pranimit të studentëve në UAMD – Viti Akademik 2022-2023
[119] Evidencë 44. Publikimi i kritereve të pranimit të studentëve për vitin akademik 2022-2023

| | |
|---|---|
| | *së Programit të Studimit, neni 35)*[120] dhe udhëzimeve të përvitshme nga MASH. Institucioni bën njohjen e lëndëve *(Referuar nenit 39, pika 4 dhe neni 47 e Rregullores së Fakultetit të Biznesit)*[121] dhe vendimeve të shpallura nga Fakulteti i Biznesit mbi transferimet[122] si dhe komunikimit që bëhet me email. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | **Po.** Programi i studimit bachelor Bankë-Financë i përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara (*Referuar nenit 53 të rregullores së Fakultetit të Biznesit)*[123]. Organizimi, strukturimi i programit të studimit bachelor Bankë-Financë dhe hartimi i syllabuseve është përcaktuar në akte ligjore e nënligjore në fuqi (*Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[124] *i ndryshuar)*[125], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[126], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[127]. |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | **Po.** Programi i studimit bachelor Bankë-Financë ka pësuar ndryshime në përmbjatje sqaruar si më poshtë:<br>Ndryshime në përmbajtjen dhe strukturën e syllabuseve të ndodhura në vitin akademik 2014-2015 ku risi ishte përfshirja e termave kyçe në gjuhën shqipe dhe angleze[128]. Ndryshime te tjera të ndodhura në vitin 2018-2019 ku për çdo temë sqarohen objektivat dhe synimet kryesore si dhe model syllabus të programit të studimit në bachelor Bankë-Financë[129]. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë[130]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | **Po.** Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive të programit të studimit bachelor Bankë-Financë është bërë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi (*Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[131] *i ndryshuar)*[132], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[133], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[134]. Lëndët e përfshira sipas veprimtarive i ofrojnë studentit të programit të studimit njohuri dhe përgatitje metodologjike të përgjithshme dhe karakterizuese duke i bërë të aftë për tregun e punës dhe të aftë për të vazhduar studimet në ciklet e mëtejshme. |

[120] Evidencë 32. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Bankë- Financë"
[121] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[122] Evidencë 49. Vendim nr. 34 mbi ngritjen e Komisioneve Ad-Hoc të transferimit të studimeve 2022-2023
[123] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[124] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[125] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[126] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[127] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[128] Evidencë 50. Prezantimi i syllabuseve dhe tezave 2014
[129] Evidencë 53. Syllabuset e lëndëve të ofruara
[130] Evidencë 53. Syllabuset e lëndëve të ofruara
[131] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[132] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[133] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[134] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | **Po.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Lëndët janë shpërndarë në semestra. Në secilin semestër përfshihen lëndë bazë, lëndë formuese dhe karakterizuese duke mos bërë më shumë se 25 orë në javë. Programi i studimit bachelor Bankë -Financë është organizuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore (*Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[135] *i ndryshuar)*[136], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[137], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[138]. |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | **Po.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit Bankë-Financë. (*Referuar Planit mësimor i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë ")*[139] Programi i studimit Bankë -Financë është i përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare[140]. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | **Po.** Programi i studimit bachelor Bankë-Financë është organizuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore (*Referuar Udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020*[141] *i ndryshuar)*[142], *(VKM-së nr. 41, datë 24.1.2018*[143], *të ndryshuar me VKM-në nr. 185, datë 25.03.2021)*[144]. Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe i mundësojnë studentëve transferim studimesh[145,146,147] brenda dhe jashtë vendit dhe mobilitet. |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | **Po.** Programet e lëndëve/moduleve të programit bachelor Bankë-Financë përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me akte ligjore e nënligjore dhe studimeve që njësia bazë bën mbi tregun lokal dhe ndërkombëtar të punës. Për të dytin vit rradhazi në kuadër të përmirësimit të programeve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës Fakulteti i Biznesit organizon panairin e punës dhe Forumin[148]. Programet e lëndëve përfshijnë literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit referuar formatit të syllabusve [149] sipas Riorganizimit të Programit të studimit bachelor Bankë-Financë, viti 2018[150] dhe 2021[151]. |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | **Po.** Përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit po ti referohemi koncepteve të fituara nga lëndët e zhvilluara garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve, mbështetur në dosjen e riorganizimit [152]. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje | **Po.** Ky program studimi ka objektiva plotësisht të qarta duke krijuar baza të qëndrueshme njohurish për studime të mëtejshme, Master Profesional, Master Shkencor[153] studime Doktorature[154, 155]. Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e |

[135] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[136] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[137] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[138] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[139] Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
[140] Evidencë 136. Programe të ngjashme Ndërkombëtare
[141] Evidencë 47. Udhëzim i MASR nr.1 dt 14.1.2020 i ndryshuar
[142] Evidencë 48. Udhëzim nr 7 datë 31.3.2021, për disa ndryshime në udhëzimin nr 1. datë 14.1.2020
[143] Evidencë 30. VKM Nr. 41 datë 24.1.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë
[144] Evidencë 54. VKM nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 41, datë 24.01.2018
[145] Evidencë 64. Transferimet e studimeve
[146] Evidencë 65. Lista e mobiliteteve të studentëve nga Fakulteti i Biznesit
[147] Evidencë 66. Info nga Alumni per punesimin pas studimeve
[148] Evidencë 61. Panairi i Punës
[149] Evidencë 53. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
[150] Evidencë 31. Riorganizimi i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë", viti 2018
[151] Evidencë 163. Riorganizimi Bachelor FB 2021
[152] Evidencë 31. Riorganizimi i Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë", viti 2018
[153] Evidencë 55. VKM Nr.1161 Datë 25.11.2009
[154] Evidencë 56. Vendimi nr. 1115, datë 13.11.2009 Për hapjen e programit të studimeve të doktoratës në UAMD
[155] Evidencë 57. Urdhëri i MASR nr.134, datë 17.03.2022

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | studimit Bachelor Bankë-Financë[156] [157]. Në Fakultetin e Biznesit është krijuar zyra ALUMNI që mundëson ruajtjen e marrëdhënieve me studentët e diplomuar[158,159]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | ✓ |

**Standardi II.5**
**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.**

| Kriteret | Vlerësimi |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | **Po.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, departamenti përgjegjës konsultohet dhe merr parasysh propozimet për ndryshime referuar "Studimit për tregun e punës[160] dhe "Studimit për ecurinë e programit të studimit[161]". Për të dytin vit rradhazi në kuadër të përmirësimit të programeve të lëndëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës Fakulteti i Biznesit organizon panairin e punës dhe Forumin[162]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | **Po.** Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje *(Referuar nenit 84, pika c e Rregullores së Fakultetit të Biznesit)[163]*. Institucioni garanton që studentët të vlerësojnë procesin akademik nëpërmjet pyetësorit drejtuar studentëve[164], në kuadër të përmirësimit të cilësisë së intitucionit (mundësuar nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë). Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë[165], ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm, neni 2 i NJSBC[166]. |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | **Po.** Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bankë-Financë ka nënshkruar marrëveshje të shumta bashkëpunimi me biznese/institucione lokale dhe kombëtare. Në funksion të këtyre marrëveshjeve njësia bazë ka përshtatur, përmirësuar përditësuar programin e studimit. Marrëveshje të tjera bashkëpunimi me insitucione dhe biznese në funksion të Departamentit Financë Kontabilitet janë nënshkruar dhe në nivel Njësie Kryesore dhe Institucioni,[167], [168] Institucioni ka ngritur Bordin Strategjik Këshillimor për Sipërmarrje dhe Inovacion për të dhënë kontribut në qasjen me tregun e punës dhe sipërmarrjen dhe përshtatjen e kurrikulave mësimore në përputhje me nevojat e tregut dhe përgjigjja e shpejtë ndaj këtyre ndryshimeve, jo vetëm në shkallë lokale, por edhe në shkallë kombëtare[169] |

[156] Evidencë 58. Studim tregu Bch Bankë-Financë
[157] Evidencë 33. Studimi për ecurinë e programit të studimit
[158] Evidencë 59. Marrëveshjen me raiffeisen për financimin e zyrës Alumni
[159] Evidencë 167. Raporti Alumni Network
[160] Evidencë 58. Studim tregu Bch Bankë-Financë
[161] Evidencë 33. Studimi për ecurinë e programit të studimit
[162] Evidencë 61. Panairi i Punës
[163] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[164] Evidencë 62. Pyetësori i studentëve
[165] Evidencë 63. Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e vetëvlerësimit të brendshëm
[166] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[167] Evidencë 69. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti
[168] Evidencë 24. Lista e marrëveshjeve në nivel Institucional të UAMD
[169] Evidencë 68. Bordi Strategjik Këshillimor për Sipërmarrje dhe Inovacion

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | **Po.** Një veçori dalluese e Universitetit "Aleksandër Moisiu" është se orët e mësimit zhvillohen të pa ndara në leksione dhe seminare (i njëjti lektor zhvillon si leksionet dhe seminaret), mbështetur kjo dhe në rregulloren e UAMD-së[170] *(Referuar nenit 60, pika 5)*, në Rregulloren e e Fakultetit të Biznesit[171] (*Referuar nenit 53, pika 1*) si dhe në Rregulloren e Provimeve. Format kryesore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë sipas Rregullores së Fakultetit të Biznesit dhe Rregullores së programit të studimit Bankë-Financë[172] dhe janë: leksionet, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni[173174]. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | **Po.** Personeli akademik paraqet në syllabusin e çdo lënde/ moduli mënyrën e organizimit të lëndës/ modulit duke përfshirë leksione, seminare, seanca diskutimi me raste studimore e praktika ushtrimore bazuar në Rregulloren e Fakultetit[175] *(Referuar nenit 53, pika 1).* Kurrikula e ofruar në programin e studimit Bachelor në Bankë-Financë është e pasur me lëndë të cilat janë në përputhje me natyrën dhe fushën specifike të studimit[176]. Për ta bërë sa më efektive mësimdhënien, stafi akademik respekton me rigorozitet dhe i përgjigjet nevojave të studentëve duke ofruar metoda të ndryshme inovative mësimdhënie në leksione dhe seminare[177]. Mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në Bankë-Financë është e gërshetuar në metoda nga më të ndryshmet si: leksionet, seancat e ushtrimeve dhe punë laboratori, si dhe prezantimin e projekteve në secilën lëndë. Departamenti përmes organizimit të workshopeve[178] , trajnimeve[179] dhe leksioneve të hapura me të ftuar ekspertë të fushave të ndryshme i mundëson stafit që të njihen me zhvillime të reja në fusha të ndryshme në përputhje me programin e studimit[180]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | **Po.** Marrëveshjet që Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka nënshkruar me institucione të ndryshme[181] kanë si qëllim të mbështesin stafin akademik në aplikimet për mobilitete trajnimi apo mësimdhënie në Universitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Këto trajnime dhe eksperienca kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive |

[170] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[171] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[172] Evidencë 32. Rregullore e programit tëstudimit Bachelor "Bankë- Financë"
[173] Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[174] Evidencë 15. Statistika me tabela
[175] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[176] Evidencë 136. Programe të ngjashme Ndërkombëtare
[177] Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[178] Evidencë 165. Workshop organizuar për Stafin Akademik nga Fakulteti Biznesit
[179] Evidencë 166. Trajnim për stafin chevening
[180] Evidencë 138. Aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet dhe aktivitetet në Fakultetin e Biznesit
[181] Evidencë 24. Lista e marrëveshjeve në nivel Institucional të UAMD

| | |
|---|---|
| | didaktive duke sjellë një frymë të re në departament[182]. Përmirësimi i aftësive didaktike të stafit akademik si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies është në qëndër të vëmendjes te Fakulteti i Biznesit. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm organizohen aktivitete të ndryshme ku ftohen për të marrë pjesë të gjithë anëtarët e stafit akademik. Analiza vjetore e Departamentit të Financë-Kontabilitetit[183] ka si qëllim kryesor të vlerësojë se sa efektive kanë qënë metodat e përdorura të mësimdhënies duke i krahasuar me objektivat formuese të këtij departamenti. Fakulteti Biznesit ka organizuar aktivitete në ambjente të Universitetit ndonjëherë dhe në ambjentet e bizneseve[184], si edhe aktivitetin e Panairit të Punës[185]. Të gjitha këto për të kuptuar më mirë nevojat që ka biznesi dhe tregu i punës[186]. Gjithashtu aktivitete të shumta në formën e leksioneve të hapura, ku ftohen ekspertë të fushave të ndryshme, janë pjesë e aktiviteteve që organizohen në ndihmë të studentëve[187]. Në këtë mënyrë programi Bachelor Bankë-Financë me anë të kurrikulave që ofron, i përgatit studentët të jenë të formuar profesionalisht dhe të jenë të gatshëm për tregun e punës. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | **Po.** Personeli akademik[188] i cili është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në Bankë-Financë ka një eksperiencë shumëvjecare[189], me përvojë mësimdhënie si në universitetet shtetërore ashtu edhe ato private brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik është i aftë në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndës që mbulon[190], si dhe mban grada dhe tituj shkencor[191] të fituar brenda dhe jashtë vendit[192]. Përdorimi i metodave interaktive ndihmon studentët që të fitojnë koncepte të reja për lëndët e programit të studimit, si edhe nxit bashkëveprimin midis studentëve dhe lektorëve po ashtu edhe midis studentëve me njëri tjetrin. Ndër të tjera studentët nxiten që të japin mendimin e tyre individual duke i angazhuar në projekte individuale, si dhe motivohen që të jenë pjesëmarrës në konferenca studentore[193][194], konkurse të ndryshme të organizuara nga AMF (Loja e Bursës), ADF (konkursi i paper-it më të mirë), pjesëmarrje në projekte në institucione të ndryshme. |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | **Po.** Departamenti i Financë-Kontabilitetit ngre çdo vit një grup pune[195] për të përgatitur analizën vjetore[196] të tij përmes së cilës vlerëson përputhjen e metodave të përdorura të mësimdhënies me objektivat formuese. Qëllimi kryesor i departamentit Financë-Kontabilitet është të përmirësojë nga njëri vit në tjetrin teknikat e mësimdhënies dhe këtë e realizon duke përfshirë edhe studentët në këtë proçes. Për çdo vit studentëve i drejtohet një pyetësor ku vlerësojnë format e përdorura nga lektorët në auditor dhe më pas sygjerimet e tyre reflektohen në department. Mënyrat dhe format e mësimdhënies të përdoruara në programin e studimit Bachelor në Bankë-Financë janë në përputhje me Rregulloren e UAMD-së (*Referuar nenit 68, pika 8*) dhe të Rregullores së Fakultetit të Biznesit[197] (*Referuar nenit 59, pika 7*). Universiteti "Aleksandër Moisiu" ofron mundësi për studentët ku një ndër këto është edhe ofrimi i Shkollës së Verës[198]. Gjithashtu po në ndihmë të studentëve dhe duke u mbështetur |

[182] Evidencë 139. Erasmus + mobilitete trajnimi dhe mësimdhënie të stafik akademik, Fakulteti i Biznesit
[183] Evidencë 77. Analiza vjetore Departamenti Financë Kontabilitet 2018-2022
[184] Evidencë 70. Raport periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit_Departamenti i Financë Kontabilitetit
[185] Evidencë 61. Panairi i Punës
[186] Evidenca 137. Marrëveshja e bashkëpunimit me Libra-aeries
[187] Evidencë 138. Aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet dhe aktivitetet në Fakultetin e Biznesit
[188] Evidencë 73. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit Financë-Kontabilitet
[189] Evidencë 77. Analiza vjetore Departamenti Financë Kontabilitet 2018-2022
[190] Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[191] Evidencë 71. Departamenti Financë-Kontabilitet - Titujt dhe Gradat në vitet 2018-2023
[192] Evidencë 74. CV e stafit akademik të brendshëm
[193] https://nscbf.uamd.edu.al/
[194] Evidencë 159. Konferenca Studentore XII
[195] Evidencë 141. Ngritja e grupeve të punës për Analizën e departamentit Financë Kontabilitet
[196] Evidencë 77. Analiza vjetore Departamenti Financë Kontabilitet 2018-2022
[197] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[198] Evidencë 140. Hapja e Shkollës së Verës

| | |
|---|---|
| | në kërkesat e tyre, Universiteti 'Aleksandër Moisiu" ka miratuar skemën e re të vlerësimit për të ulur kufirin e kalueshmërisë, ndërkohë që skema e vlerësimit që është aplikuar më parë e kishte kufirin e kalueshmërisë prej 595 pikësh për të marrë notën kaluese pesë, ndërsa tani për të marrë notën pesë, studentit i duhen vetëm 505 pikë. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | **Po.** Në Universitetin "Aleksandër Moisiu" për të rritur dhe garantuar cilësinë e mësimdhënies është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë[199], aktiviteti i së cilës është e mbështetur në rregulloren e kësaj njësie. Universiteti "Aleksandër Moisiu" mbështet përdorimin dhe promovimin e metodave të reja inovative në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies mbështetur në Rregulloren e Departamentit Financë-Kontabilitet[200] (*Referuar nenit 19*). Universiteti dhe njësitë përgjegjëse angazhohen që të trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja nëpërmjet angazhimit të personelit në mobilitete në kuadër të programeve Erasmus +[201]. Gjithashtu është bërë tashmë traditë që prej 12 vitesh organizimi i Konferencës Studentore[202][203] pranë Fakultetit të Biznesit, në të cilën gërshetohen krijimet individuale të studentëve me asistencën profesionale të dhënë nga lektorët. Gjithashtu, lektorët e departamentit Financë-Kontabilitet nxisin studentët që me anë të projekteve/detyrave të kursit të marrin pjesë në konkurse të ndryshme të organizuara nga Banka e Shqipërisë apo edhe në konferencat e organizuara nga Agjensia Mbikqyrjes Financiare. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | **Po.** Rregullorja e UAMD-së[204] (*Referuar nenit 68, pika 1-6*) si dhe Rregullorja e Provimeve[205] (*Referuar nenit 2*) specifikon mënyrën e vlerësimit të njohurive në Universitetin "Aleksandër Moisiu" dhe në Fakultetin e Biznesit. Studentët njihen me mënyrën dhe skemën e vlerësimit gjatë shpjegimit të syllabusit të çdo lënde. Lektori i lëndës ka detyrë që pasi ka bërë korrigjimin e provimeve të bëjë ballafaqimin me studentët[206] duke parë gjithësecili tezën e tij të provimit, dhe më pas të hedhë notat në sistemin pitagora dhe të nxjerrë procesverbalin. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | **Po.** Bazuar në Rregulloren e Fakultetit[207] (*Referuar nenit 53, pika 3*), Rregulloren e UAMD-së[208] (*Referuar nenit 62, pika 3*) në javën e parë të leksionit, çdo lektor prezanton syllabusin e lëndës/modulit duke informuar studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Lektori jep informacione të detajuara për mënyrën e vlerësimit të lëndës/modulit përmes sistemit të pikëve të shpërndara në provimin e ndërmjetëm, provimin përfundimtar si dhe detyrave të kursit. |

[199] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[200] Evidencë 119. Rregullore e Departamentit Financë Kontabilitet
[201] Evidencë 139. Erasmus + mobilitete trajnimi dhe mësimdhënie të stafik akademik, Fakulteti i Biznesit
[202] https://nscbf.uamd.edu.al/
[203] Evidencë159. Konferenca Studentore XII
[204] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[205] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[206] Evidencë 146. Njoftim Ballafaqim tezash me studentët
[207] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[208] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | **Po.** Në javën e parë të prezantimit të syllabusit, lektori ka prezantuar dhe mënyrën e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Kështu, sipas Rregullores së Provimeve[209] (*Referuar nenit 2*) vlerësimi bëhet me provime në secilën lëndë, ku provimi i ndërmjetëm ka 400 pikë, provimi përfundimtar 500 pikë dhe 100 pikë meren nga detyrat e kursit, projektet, esetë të cilat mund të realizohen në mënyra të ndryshme në varësi të lëndës duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë lëndës/modulit siç është cituar në Rregulloren e Fakultetit[210]( *Referuar nenit 59, pika 6*). Bazuar po në Rregulloren e Fakultetit[211] (Referuar nenit 60, pika 6) tezat e provimit duhet të jenë të përgatitura sipas formatit të miratuar në njësinë bazë dhe nënshkruhen nga Përgjegjësi i Departamentit, jo më vonë se dita e fundit e javës që paraprin provimin. |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | **Po.** Departamenti i Financë-Kontabilitetit ngre çdo vit një grup pune[212] për të përgatitur analizën vjetore[213] të tij përmes së cilës vlerëson përputhjen e metodave të përdorura të mësimdhënies me objektivat formuese. Qëllimi kryesor i departamentit Financë-Kontabilitet është të përmirësojë nga njëri vit në tjetrin teknikat e mësimdhënies dhe këtë e realizon duke përfshirë edhe studentët në këtë proces. Çdo vit studentëve i drejtohet një pyetësor ku vlerësojnë format e përdorura të mësimdhënies nga lektorët në auditor dhe më pas sygjerimet[214] e tyre reflektohen te anëtarët e departamentit. Mënyrat dhe format e mësimdhënies të përdoruara në programin e studimit bachelor Bankë-Financë janë të shprehura në Rregulloren e UAMD-së[215] (*Referuar nenit 68, pika 6*) dhe Rregullores së Fakultetit të Biznesit[216] (*Referuar nenit 59, pika 6*) |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | **Po.** Programi i studimit në Bachelor Bankë-Financë, ka një kurrikul mjaft të pasur të ngjashme me ato të universiteteve ndërkombëtare[217], dhe ofron për studentët zhvillimin e aftësive jo vetëm në fushën përkatëse të studimit por edhe më gjerë, duke nxitur tek ata mendimin kritik. Detyrat e kursit apo projektet në çdo lëndë i krijojnë mundësi studentëve të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin, të ndërthurin teorinë me praktikën, rastet studimore si dhe përdorimin e programeve të ndryshme kompjuterike. Në syllabusin e çdo lënde, në pjesën e literaturës, sygjerohet që krahas literaturës së detyruar në gjuhën shqipe studentët të përdorin dhe literaturë të huaj ndihmëse. Kjo i ndihmon studentët për të zgjeruar akoma dhe më shumë njohuritë e fituara përgjatë viteve të studimit. Sipas Rregullores së Fakultetit të Biznesit[218], termat kyçe pjesë e syllabusit të çdo lënde përveç gjuhës shqipe janë të përkthyera dhe në anglisht në mënyrë që studentët të aftësohen akoma dhe më shume me konceptet bazë. Gjithashtu studentët e departamentit Financë-Kontabilitet të mbështetur dhe nga lektorët e tyre marrin pjesë në konferencat e organizuara nga Agjensia Mbikqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë.[219] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

[209] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[210] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[211] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[212] Evidencë 141. Ngritja e grupeve të punës për Analizën e departamentit Financë Kontabilitet
[213] Evidencë 77. Analiza vjetore Departamenti Financë Kontabilitet 2018-2022
[214] Evidencë 169. Vlerësimi i lektorëve Raportet e Fakultetit të Biznesit
[215] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[216] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[217] Evidencë 136. Programe të ngjashme Ndërkombëtare
[218] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[219] Evidencë 168. Pjesëmarrje e studentëve konkurs me temë Bursa Virtuale e Titujve

| Standardi III.3<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | **Po.** Sipas Rregullores së Provimeve (*Referuar nenit 2*) dhe Rregullores së Fakultetit të Biznesit (*Referuar nenit 60)* në secilën lëndë gjatë një semestri zhvillohen 2 provime[220]. Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik me provime dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar për çdo lëndë. Për të rritur transparencën e kryerjes dhe korrigjimit së provimeve, gjatë viteve akademike 2018-2021 e në vazhdim në lëndë specifike është aplikuar platforma Clean Score[221]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu" përdor një sistem efiçent dhe praktik për zhvillimin e provimeve siç është platforma Clean Score e aplikuar fillimisht në vitin akademik 2017-2018 dhe vazhduar të përdoret dhe në vitet e fundit akademike[222][223] . Ky lloj sistemi ka rezultuar shumë efektiv sepse mundëson korrigjimin automatik të tezave të provimeve. Gjatë pandemisë, lektorët krahas përdorimi të sistemit elektronik të Clean Score kanë pasur edhe mundësi të ndryshme si përdorimi i google form apo quizlet nga sistemi Microsoft Teams[224]. Ka lektorë që vazhdojnë të përdorin të tilla sisteme të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | **Po.** Sipas rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu"[225], Fakultetit të Biznesit[226], si dhe rregullores së programit të studimit[227] dhe provimeve[228] vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Lektori vlerëson njohuritë e përftuara përmes provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar si dhe detyrave të kursit, projekteve apo ushtrimeve praktike që i ka paraqitur në syllabus. Përgjegjësi i departamentit ka për detyrë të ngrejë komisione për provimet 1000 pikëshe të sezoneve të ndërmjetme, bazuar në Rregulloren e UAMD-së[229] (*Referuar nenit 72*) dhe në Rregulloren e Provimeve[230] (*Referuar nenit 6*). |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | **Po.** Lektori vendos në dispozicion të studentëve adresën e tij të emailit të paraqitur në syllabus në mënyrë që studentët të mund të adresojnë problematika apo paqartësi që ata mund të kenë në lidhje me lëndën. Në të njëjtën kohë, lektori krijon hapësira online si p.sh në Google Classroom[231] ku komunikohet me të gjithë studentët. Këtu ata mund të dorëzojnë detyra dhe ushtrime përmes të cilat lektori vlerëson njohuritë e dijet e marra dhe jep këshilla mbi proçesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Mundësia për të ballafaquar tezën e provimit rrit transparencën dhe objektivitetin e komunikimit të lektorit me studentët. Studentët kanë mundësinë që gjatë ballafaqimit të provimit lektorët ti evidentojnë pikat e dobëta të provimit për secilin prej tyre, dhe duke rritur në këtë mënyrë shanset që studentët të përmirësojnë rezultatet e tyre në provimet pasardhëse. |

[220] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[221] Evidencë 142. Email Njoftim Clean Score dixhitalizimit të procesit të zhvillimit të provimeve
[222] Evidencë 143. Trajnim për Clean Score 2018-2019
[223] Evidencë 144. Takim me përfaqësuesen e CleanScore Durrës dhe Departamentit Financë-Kontabilitet
[224] Evidencë 170. Njoftim për përdorim të platformës Microsoft Teams
[225] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[226] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[227] Evidencë 32. Rregullore e programit tëstudimit Bachelor "BankëFinancë"
[228] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[229] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[230] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[231] Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | **Po.** Shmangia e plagjiaturës është një çështje shumë e rëndësishme në fushën akademike, dhe për këtë arsye personeli akademik i kushton vëmendje të veçantë origjinalitetit të detyrave të punura nga studentët gjatë vitit akademik. Për të arritur këtë qëllim, në lëndë të ndryshme jepen alternativa të ndryshme detyrash kursi, si punë individuale apo në grup. Për disa lëndë studentit i kërkohet të ndërtojë hartën konceptuale të çdo kapitulli, ndërsa në lëndë të tjera u kërkohet të trajtohet tematika të ndryshme që kanë lidhje me syllabusin e lëndës. Në syllabusin e lëndës është përcaktuar Kodi i Etikës ku shprehimisht thotë se "*Studentët gjatë lëndës duhet të mos kopjojnë në punën e dikujt tjetër, të mos fabrikojnë të dhëna e të respektojnë dinjitetin e integritetin njerëzor e profesional të studentëve të tjerë.*" Gjatë sezoneve të provimeve, ashtu sikurse është e specifikuar në Rregulloren e Provimeve (*Referuar nenit 4 dhe nenit 5*[232]) proçesi i provimeve zhvillohet në prani të lektorit të lëndës dhe një lektori asistues[233]. Rastet specifike kur studentët tentojnë të kopjojnë në provim ose që nuk i binden rregullave të provimit shoqërohen me mbajtjen e procesverbalit nga ana e lektorit dhe asistuesit, e shprehur kjo në Rregulloren e Provimeve, fq 11[234]. Gjithashtu, programi antiplagjiaturë, i vendosur në Shtator të 2022, do ndihmojë në kontrollin e detyrave dhe temave të diplomës me sistemin antiplagjiaturë. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | **Po.** Një ndër parimet themelore të Institucionit është garantimi i të drejtave të studentit. Referuar Rregullores së Fakultetit të Biznesit[235], rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë[236]. Këto rezultate lektori i bën transparent duke bërë ballafaqimin e rezultatit me studentin përpara publikimit të vlerësimit final të lëndës. |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.<br><br>**Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | **Po.** Objektivi kryesor i Universitetit "Aleksandër Moisiu" është garantimi i të drejtave të studentit. Sipas Rregullores së Provimeve[237] (*Referuar nenit 4-6*) si dhe Rregullores se Fakultetit të Biznesit[238] (*Referuar nenit 62*) detyra e çdo lektori është garantimi i të drejtës së studentëve për tu ballafaquar me rezultatin e provimeve[239] dhe të drejtën e tyre për ankimim të rezultatit në rastin kur e gjykon të pa drejtë vlerësimin.<br><br>**Po.** Çdo kërkesë e studentëve në lidhje me ankesat për rezultatet e provimit të zhvilluar, përgjegjësi i departamentit Financë-Kontabilitet ngre një komision për të rishqyrtuar tezën e provimit dhe mënyrën e korrigjimit. Proçedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet[240] pranë sekretarisë mësimore sipas rregullores së Fakultetit të Biznesit[241] (*Referuar nenit 62*), rregullores së programit të studimit Bachelor Bankë-Financë[242] (*Referuar nenit 27*). |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

[232] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[233] Evidencë 164. Grafiku i asistimeve Bachelor
[234] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[235] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[236] Evidencë 146. Njoftim Ballafaqim tezash me studentët
[237] Evidencë 132. Rregullore e Provimeve të Fakultetit të Biznesit
[238] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[239] Evidencë 146. Njoftim Ballafaqim tezash me studentët
[240] Evidencë 145. Memo për ngritje komisionesh të posaçme për të rikorigjim teze.
[241] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[242] Evidencë 32. Rregullore e programit téstudimit Bachelor "Bankë-Financë"

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | **Po.** Programi i studimit Bachelor Bankë-Financë[243] ka një kurrikul[244] të pasur që garanton pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, trajnim të mirëfilltë dhe profesional dhe i përgatit ata të jenë të aftë të përballen me sfidat e tregut të punës[245]. Gjithashtu në funksion të garantimit të cilësisë së mësimdhënies është ngritur Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, aktiviteti i së cilës është e mbështetur në rregulloren e kësaj njësie[246] dhe e grupeve të posaçme kërkimore-shkencore me vendim Senati dhe Dekanati[247]. Shpallja e kandidaturave, kritereve që duhet të plotësojë drejtuesi i grupit kërkimor-shkencor dhe më pas emërimi i tij bëhet nga drejtuesi i njësisë bazë[248249]. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | **Po.** Nëpërmjet kurrikulës që programi i studimit Bachelor Financë- Kontabilitet ofron dhe kategorive A/B/C/D të planit mësimor, referuar dhe syllabusve të lëndëve që zhvillohen, ky program studimi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.<br>Lektorët angazhohen përmes metodologjisë së mësimdhënies dhe në zbatimin e rasteve praktike për zhvillimin e aftësive të studentëve. Po ashtu, për lëndë të caktuara në kurrikul lektorët i referohen dhe përdorimit të programeve kompiuterike për regjistrim të dhënash. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | **Po.** Në përfundim të çdo lënde lektorët realizojnë një orë përsëritje ku vënë në pah çështjet kryesore ku do të mbështeten studentët për provimin përfundimtar, referuar syllabusit të lëndës. Në dispozicion të studentëve janë edhe oraret e konsultimeve që shpallen nga secili pedagog në fillim të çdo viti akademik[250]. Nga ana tjetër studentët kanë një javë pushim, e cila është cilësuar si javë për të bërë përsëritje të lëndëde që do të përfshihen në provim[251]. Në fund të çdo semestri, lektorët nën kordinimin e kordinatorit të programit të studimit dhe drejtuesit të njësisë bazë bëjnë orientimet e nevojshme për detyrimet përmbyllëse. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara | **Po.** Në përfundim të vitit të tretë, programi i studimit Bachelor Bankë-Financë i jep mundësi studentëve të zhvillojnë praktikat profesionale[252] . Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti Financë-Kontabilitetit ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione dhe subjekte që ndihmojnë studentët të bëjnë praktika profesionale[253] dhe trajnime[254].<br>Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato nëpërmjet përfshirjes së studentëve në organizimin e Konferencës Studentore[255256].<br>Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese brenda dhe jashtë vendit duke ndihmuar që studentët të bëhen gjithashtu pjesë e projekteve të mobiliteteve, si Erasmus +[257]. |

243 https://uamd.edu.al/bachelor-banke-finance/
244 Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
245 Evidencë 58. Studim tregu Bch Bankë-Financë
246 Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
247 Evidencë 149. Ndarja e grupeve mësimore kërkimore shkencore në Departamentin FK
248 Evidencë 150. Kriteret për zgjedhjen e grupeve kërkimore shkencore
249 Evidencë 149. Ndarja e grupeve mësimore kërkimore shkencore në Departamentin FK
250 Evidencë 147. Orari i konsultimeve
251 Evidencë 148. Vendimi i Senatit Akademik_Kalendari Akademik për ciklin Bachelor
252 Evidencë 35. Plani mësimor dhe kurrikula e Programit të studimit Bachelor "Bankë-Financë"
253 Evidencë 69. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti
254 Evidencë 171. Trajnim studentët
255 Evidencë 159. Konferenca Studentore XII
256 Evidencë 160. Historiku dhe njoftime të konferencës studentore
257 Evidencë 135. Pjesëmarrjet në programet Erasmus + Studentët

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | | | | |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | **Po.** Leksionet e hapura janë një traditë shumëvjeçare e Fakultetit të Biznesit dhe e departamentit Financë Kontabilitet[258], gjatë të cilëve ftohen ekspertë të fushës për të ndarë me studentët njohuritë dhe përvojat e tyre. Institucioni në bashkëpunim me partnerë të fushave të ndryshme për të rritur edhe më shumë shkallën e përfitimeve për studentët dhe stafin akademik, organizon në faza të ndryshme të proçesit mësimor leksione të hapura dhe aktivitete të ndryshme[259]. Gjithashtu pjesë e këtij aktiviteti janë dhe lektorë të huaj[260] të cilët krahas mësimdhënies zhvillojnë dhe leksione të hapura me studentët e Fakultetit të Biznesit. Institucioni mbështet dhe i nxit studentët të bëhen pjesë e trajnimeve dhe ideve inovatore nëpërmjet thirrjeve të ndryshme[261] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | ✓ |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | **Po.** Institucioni harton rregulloren e detyrimeve përmyllëse [262] (*Referuar nenit 2*), rregulloren e programit të studimit[263] (*Referuar neni 21, pika 2*) ku studentët e programit të studimit bachelor Bankë-Financë do të përmbushin detyrimet përmbyllëse në varësi të notës mesatare. Nëse studenti ka notë mesatare mbi notën 7 atëherë studenti i përmbush detyrimet përmbyllëse me punim diplome. Nëse studenti ka notë mesatare nën notën 7 atëherë studenti i përmbush detyrimet përmbyllëse duke zhvilluar provim të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | **Po.** Strukturat përgjegjëse sipas Rregullores së detyrimeve përmbyllëse[264] (*Referuar nenit 4 dhe 5*) asistojnë studentët nëpërmjet seancave të orientimit në auditore, njoftime me emaile, njoftime në rrjetet sociale etj në hartimin e temës së diplomës por edhe të provimit përfundimtar[265]. Lektori udhëheqës ka për detyrë të asistojë studentët në zgjedhjen e temës së diplomës[266], duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Udhëheqësi duhet të garantojë se do të zbatojë të gjitha rregullat e udhëheqjes së tezës. Gjithashtu në rast se studenti për të mbyllur ciklin e parë të studimeve duhet të zhvillojë provimin përmbyllës, është detyra e stafit akademik të departamentit Financë-Kontabilitet që ti vendosë në dispozicion bllokun e pyetjeve përgatitore për secilën lëndë të përfshirë në provim. |

[258]Evidencë 138. Aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet dhe aktivitetet në Fakultetin e Biznesit
[259]Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[260]Evidencë 152. Tabela me profesorët e huaj që kanë dhënë mësim në Fakultetin e Biznesit
[261]Evidencë 172. Konkursi Kombëtar i Punimeve Kërkimore
[262]Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[263]Evidencë 32. Rregullore e programit të studimit Bachelor "Bankë- Financë"
[264]Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[265]Evidencë 153. Ngritje komisioni AD-hoc për vlerësimin e provimit të Diplomës Bachelor Departamenti Financë Kontabilitet
[266]Evidencë 134. Komunikimi me e-mail për udhëheqjet

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | **Po.** Sipas Rregullores së Detyrimeve përmbyllëse [267] (*Referuar nenit 12*) për studentët që nuk marrin tezë diplome, në fillimin e semestrit përmbyllës departamenti i Financë-Kontabilitetit, përgatit pyetje për çdo lëndë të disiplinës *Lëndë Karakterizuese* në kurrikulën e programit të studimit Bachelor Bankë-Financë, pyetje të cilat u vihen në dispozicion studentëve. Komisioni i posaçëm[268] bazohet në krijimin e provimit final[269], në grup pyetjet e disiplinës Lëndë karakterizuese. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | **Po.** Departamenti afishon listën e personelit akademik me titujt përkatës, gradat, fushat e studimit dhe adresat e tyre elektronike me qëllim që studentët të zgjedhin udhëheqësit për tezën e diplomës. Sipas rregullores së diplomimit udhëheqësit për tezën e diplomës propozohen dhe miratohen nga departamenti. Pas miratimit, çdo lektor udhëheqës i komunikon studentit me email[270] që ai do e udhëheq dhe që në këtë moment *Udhëheqësi* i diplomës orienton dhe ndihmon studentin që në përcaktimin e temës së punimit të diplomës dhe në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit në bazë të rregullores së diplomimit[271] (*Referuar aneksi 6*). |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | **Po.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e detyrave të kursit dhe në punimin e temës së diplomës duke i vendosur në dispozicion laboratorët dhe bibliotekën[272][273][274] (online dhe fizikisht[275]). Në mënyrë që studentët të paraqesin tema dhe punime sa më dinjitoze, institucioni me anë të bashkëpunimeve me partnerët ka bërë të mundur ndërtimin e një laboratori me kompjutera, i cili i vjen në ndihmë studentëve për përfitim sa më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. Gjithashtu në çdo sezon diplomimi, departamenti organizon një leksion të hapur që studentët të mësojnë si të shkruajnë një punim shkencor të mirëfilltë. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | **Po.** Sipas rregullores së shlyerjeve të detyrimeve përmbyllëse[276] (*Referuar ankesi 1*) (*Referuar ankesi 7*) modeli i shpalljes se rezultateve të provimit përfundimtar[277]/ temë diplome dhe (*Referuar Kreu 3, Neni 2, pika 5,7*) studenti diplomohet duke mbrojtur temën e diplomës/ provimin përfundimtar (*Referuar kreu II, neni 6, pika 8*) përpara një komisioni dhe vlerësohet me notë. |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | **Po.** Në bazë të rregullores së shlyerjeve të detyrimeve përmbyllëse[278] (*Referuar Kreu II, Neni 6, pika 8*) studentët që kalojnë me sukses temën e diplomës apo provimin e përgjithshëm përfundimtar të diplomimit pajisen me diplomën përkatëse në përputhje dhe me rregulloren e Fakultetit të Biznesit[279] (*Referuar pikës 1, gërma c) të Nenit 67*) Gjithashtu në Rregulloren e Sekretarisë për Fakultetin e Biznesit[280] (*Referuar Nenit 23 dhe Nenit 24*) shprehet se një ndër detyrat e institucionit është që në përfundim të studimeve, studenti të pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës[281], të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit njoftohen për tërheqjen e diplomës dhe suplementit. |

[267] Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[268] Evidencë 154. Ngritje komisioni AD-hoc për mbrojtjen diplomës Bachelor
[269] Evidencë 155. Komunikimi për Provimin final
[270] Evidencë 134. Komunikimi me e-mail për udhëheqjet
[271] Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[272] Evidencë 107. ULIBRARY
[273] Evidencë 111. Vendimi i funksionimit të bibliotekës edhe në fundjavë
[274] Evidencë 108. Marrëveshjet e Bibliotekës për të përdorur aksesin elektronik JStore
[275] Evidencë 100. Aksesi online në bibliotekë
[276] Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[277] Evidencë 157. Procerverbal provimi përmbyllës BF
[278] Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[279] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[280] Evidencë 113. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit
[281] Evidencë 158. Suplemente Bachelor Bankë Financë

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | **Po.** Sekretaria mësimore e Fakultetit të Biznesit[282] vendos në dispozicion të studentëve dokumentacionin e kërkuar. Databaza e sekretarisë mësimore ruan të dhëna për një periudhë të caktuar të të gjithë studentëve të regjistruar në të gjitha ciklet e studimit. Institucioni e ka të detyrueshme të ruajë dhe arkivojë sipas një afati të caktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, informacione për studentët për to nëse kërkohen.[283] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | **Po.** Programi i studimit bachelor Bankë-Financë mbulohet nga Njësia Bazë, Departamenti Financë Kontabilitetit. Në departamentin Financë-Kontabilitet janë 16 lektorë efektiv, nga të cilët 1 Profesor Doktor, 1 Profesor i asociuar, 9 Doktorë Shkencash, 5 doktorantë në proces, ku kualifikimi i tyre është i shpërndarë sipas të dhënave statistikore "Tituj dhe Grada", viti 2018-2023[284]. Personeli akademik dhe ndihmës akademik i angazhuar në programin e studimit bachelor Bankë-Financë mban grada dhe kualifikime në përputhje me Ligjin nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" (*Referuar nenit 59, pika 6*)[285]. Arsimimi i lektorëve të departamentit Financë-Kontabilitet dhe rritja e tyre akademike në tituj dhe grada janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve që ata mbulojnë[286]. Angazhimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik është në zbatim të rregullores së Fakultetit të Biznesit (*Referuar nenit 24, pika 3*)[287] dhe të fushave të kërkimit shkencor të departamentin Financë-Kontabilitet[288]. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit bachelor Bankë-Financë referuar fushës së studimit të tyre në dosjet e Vetëvlerësimit[289] dhe në CV e rifreskuara[290] janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. |

[282] Evidencë 113. Rregullore e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Biznesit
[283] Evidencë 36. Rregullore e detyrimeve përmbyllëse
[284] Evidencë 71. Departamenti Financë-Kontabilitet - Titujt dhe Gradat në vitet 2018-2023
[285] Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
[286] Evidencë 72. Përputhja e Formimit me angazhimin për personelin akademik Financë-Kontabilitet
[287] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[288] Evidencë 94. Fushat kërkimore të Departamentit Financë-Kontabilitet
[289] Evidencë 73. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit Financë-Kontabilitet
[290] Evidencë 74. CV e stafit akademik tëbrendshëm

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | **Po.** Personeli akademik efektiv në bazë të Udhëzimit[291] nr 29 i datës 10.09.2018, për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik, të klasifikuar në kategoritë përkatëse si profesorë, lektorë, asistent-lektorë, ka mbuluar ngarkesën mësimore[292] për programin e studimit bachelor Bankë-Financë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | **Po.** Institucioni garanton dhe dëshmon për qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv mbasi në departamentin Financë-Kontabilitet stafi akademik efektiv ka një eksperiencë në mësimdhënie rreth 10 vjet (duke lëvruar nga minimumi shtatë vite në maksimumi njëzet e gjashtë vite).[293] Për personelin akademik profesor dhe lektorë kemi punësimin e tyre me kontratë[294] me kohëzgjatje të pacaktuar dhe asistent-lektorët janë punësuar me kontratë me kohëzgjatje të caktuar. Çdo muaj Drejtoria e Shërbimeve Financiare e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës i përcjell me e-mail raportimin e pagës personelit akademik ku janë të detajuara dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. [295] |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës rekruton personel akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në përputhshmëri të plotë me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" (*Referuar nenet 64-67*), Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, të Rregullores së UAMD[296] (*Referuar nenit 103,104*) dhe në Statutin e UAMD[297] (*Referuar nenit 45,46*). Në varësi të strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Administrimit nr. 30, datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", përcaktohen kriteret[298] që vendosen nga Departamenti i Financë Kontabilitetit që është njësia Bazë dhe janë kritere si mesatarja e studimeve, fusha e studimeve, eksperienca në mësimdhënie, publikimet, trajnimet, kritere që duhet të përmbushen nga aplikanti.<br>Mbi bazën kritereve të përcaktuara nga njësia bazë, shpallet konkurs i hapur "Për vendet të lira të punës për personel akademik me kohë të plotë" (ose të pjesshme) dhe kryhet publikimi në Buletinin e Njoftimeve Publike pranë Agjensisë së Prokurimeve Publike[299], në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen edhe në faqen zyrtare të UAMD[300]. Për çdo vend vakant të publikuar përshkruhen pozicioni i punës, kriteret që duhet të përmbushen nga aplikanti, dokumentacioni i kërkuar, afatet e aplikimit jepet gjithashtu në formë elektronike një formular aplikimi për personelin akademik[301] dhe administrativ[302]. Vlerësimi i kandidaturave bëhet në dy faza: Kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjes i nënshtrohen intervistës. Vlerësimi i dosjes përmban 70 % të vlerësimit, intervista përmban 30 % të vlerësimit. Për të garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e studimit, ngrihet një komision Ad-Hoc[303] pranë Departamentit Financë Kontabilitet i cili vlerëson dhe përzgjedh kandidatët sipas kritereve[304]. Drejtuesi i Njësisë Kryesore i paraqet Rektorit renditjen e kandidatëve sipas Vendimit të komisionit ad hoc dhe Rektori lidh kontratë pune me kandidatin/ kandidatët e përzgjedhur, mbështetur në legjislacionin në fuqi[305]. |

[291] Evidencë 75. Udhëzim nr. 29 datë 10.09.2018, Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik.
[292] Evidencë 15. Statistika me tabela
[293] Evidencë 77. Analiza vjetore e departamentit Finance Kontabilitet viti akademik 2018-2022
[294] Evidencë 78. Model Kontrate Pune – UAMD
[295] Evidencë 79. Raportimi mujor i pagës
[296] Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
[297] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[298] Evidencë 80. Kritere dhe vende vakante stafi i ri ndër vite
[299] *www.app.gov.al*
[300] *www.uamd.edu.al* https://uamd.edu.al/mundesi-punesimi/
[301] Evidencë 81. Formular Aplikimi Akademik
[302] Evidencë 82. Formular Aplikimi Administrativ
[303] Evidencë 83. Ngritje komision rekrutimi staf i ri 2020-2021
[304] Evidencë 84. Vendim Rekrutime lektorë PT 29.10.2020
[305] Evidencë 85. Procedura dhe formularët e përdorur për rekrutimin e personelit në UAMD

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | **Po.** Institucioni nëpërmjet Sektorit të Teknologjisë së Informacionit kujdeset për mirëmbajtjen e sistemit ekzistues të kompjuterave (në drejtim hardware dhe software). Personeli ndihmës akademik i Fakultetit të Biznesit është i përbërë nga sekretaria e ciklit të parë bachelor, asistentja e departamentit dhe dy laborantë[306], të cilët ofrojnë suport për veprimaritë mësimore të stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme. Ky personel ka kualifikimin e duhur dhe i përshtatet nevojave dhe natyrës specifike të programit të studimit. |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | **Po.** Në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës të dhënat e personelit akademik me kohë të plotë, personelit ndihmës akademik dhe administrativ mblidhen, ruhen dhe përditësohen si dokumentacion i plotë dhe i rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale[307]. Dega e Burimeve Njerëzore në bazë të Statutit[308] të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (*Referuar nenit 24*), e njohur si Njësi Ndihmëse Qëndrore Administrative është përgjegjëse për përditësimin e dosjeve të stafit akademik me kohë të plotë, personelit ndihmës akademik dhe administrativ duke e vënë informacionin në dispozicion të njësive kryesore dhe të atyre bazë. Dega e Burimeve Njerëzore në bazë të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore[309] dhe Juridike ndjek procedurat ligjore në lidhje me marrëdhënien kontraktuale[310] të stafit me Universitetin "Aleksandër Moisiu". Çdo vit akademik personeli akademik plotëson formularët e vetëvlerësimit ku pasqyrohet progresi shkencor dhe akademik mbi të cilin bëhet vlerësimi i performancës[311]. Njësia bazë dhe njësia kryesore hartojnë çdo vit analizën vjetore në të cilën janë të përmbledhura të dhënat për stafin akademik dhe jo akademik.[312] Gjithashtu "Baza e të dhënave të Kërkimit Shkencor"[313] mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit të kërkimit shkencor duke mundësuar një vlerësim periodik dhe një rankim në kohë reale të tij. Ky rankim bëhet në nivel kombëtar (sipas fushave) përmes portalit "Vlerësimi i veprimtarisë kërkimore shkencore", në platformën ACRIS (Sistemi shqiptar i informacionit të kërkimit shkencor) që administrohet nga RASH[314]. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Biznesit dhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit kanë marrëveshje me IAL dhe organizata biznesi, partnerë institucionale si: Drejtoria Rajonale Tatimeve, Drejtoria Rajonale e Doganave, ISKSH, ALSA, Dhomat e Tregtisë, Kompanitë e sigurimit dhe Institucione të tjera financiare banka dhe jo banka, partnere sipërmarrës si biznese private, kontabilistë të miratuar, ekspert kontabël të regjistruar etj, me qëllim përmbushjen sa më mirë të veprimtarisë mësimore për aftësimin praktik të studenteve[315]. Studentët kanë në dispozicion Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike që ka nën varësi Sektorin e Karrierës dhe të Alumnit, ku (*Referuar nenit 15*) të rregullores së kësaj Drejtorie përcakton funksionimin e Sektorit të Karrierës dhe Alumni dhe shërbimeve që ajo ofron për studentët në procesin e praktikës dhe punësimit[316]. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale | **Po.** Sigurimi i marrëveshjeve[317]do të ndihmojë për të realizuar praktikat mësimore për studentët në programet e studimit bachelor Bankë-Financë dhe për të realizuar punësimin dhe trajnimet e studentëve sipas vendeve vakante të ofruara nga bizneset |

[306] Evidencë 15. Statistika me tabela
[307] Evidencë 87. Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale
[308] Evidencë 6. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
[309] Evidencë 88. Rregullore e Brendshme: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike
[310] Evidencë 78. Model Kontrate Pune – UAMD
[311] Evidencë 73. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit Financë-Kontabilitet
[312] Evidencë 77. Analiza vjetore e departamentit Finance Kontabilitet viti akademik 2018-2022
[313] Evidencë 90. Rregullore e mbajtjes së bazës së të dhënave të kërkimit shkencor
[314] https://kerkimi-shkencor.rash.al/
[315] Evidencë 23. Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025
[316]Evidencë 91. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike
[317] Evidencë 69. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel Fakulteti

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | dhe në bazë të Rregullores së Praktikës Mësimore përcaktohet procesi i zhvillimit të praktikës mësimore për bachelor Bankë-Financë të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | ✓ |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | **Po.** Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, ka një vendodhje të përhershme duke zhvilluar procesin mësimor në tre godina, një në Currila dhe dy në Kampusin Universitar, Spitallë duke krijuar kushtet e nevojshme, të përshtatshme dhe të barabarta për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, Fakulteti i Biznesit e zhvillon procesin mësimor dhe veprimtarinë akademike në Godinën Nr. 2 të Kampusit Universitar, Spitallë. Në godinën Nr.2 [318] të Kampusit Universitar Departamenti i Financë Kontabilitetit zhvillon mësimdhënien e programeve të veta në hapësira të mjaftueshme për numrin e studentëve që ka aktualisht. Në dispozicion janë 15[319] auditorë me një kapacitet prej 1266 vende, 2 laboratorë me një kapacitet prej 80 vendesh, 1 sallë konference me një kapacitet prej 200 vende të pajisura me infrastrukturën e nevojshme. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | **Po.** Mjediset mësimore dhe laboratorike në Fakultetin e Biznesit, që ndodhen në godinën Nr.2 të Kampusit Universitar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, janë të pajisuara me të gjitha pajisjet e nevojshme teknologjike dhe digjitale që janë të nevojshme për procesin e mësimdhënies dhe mësim nxënies. Klasat e godinës Nr.2 të Kampusit Universitar në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës janë të pajisura me tabela witeboard dhe videoprojektor të lëvizshëm dhe të montuar të cilat mundësojnë zhvillimin e mësimit në kushte bashkëkohore.<br>Në këtë godinë ndodhet edhe Departamenti i Financë Kontabilitetit me zyrat e personelit akademik dhe administrativ, të cilat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme (kompjuter, printer, tavolinë pune, dollap etj). Laboratorët janë të përshtatshëm për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve. [320][321]. |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të | **Po.** Fakulteti i Biznesit ka dy laboratorë që janë në funksion të studentëve bachelor Bankë-Financë, me gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 $m^2$. Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike si Financa 5 për plotësimin e nevojave të studentëve për studim dhe kërkim shkencor.[322] Gjithashtu Fakultetit të Biznesit i është shtuar dhe laboratori i Doktoraturës i cili është i pajisur me softwarët e fundit si eviews/ spss/ program antiplagjiaturë/ Grammarly[323]. |

[318] Evidencë 17. Planimetria e Fakultetit të Biznesit
[319] Evidencë 17. Planimetria e Fakultetit të Biznesit
[320] Evidencë 97. Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB
[321] Evidencë 34. Përmbledhëse e Metodave interaktive të përdorura për mësimdhënie
[322] Evidencë 97. Informacion mbi pajisjet hardware dhe software në FB
[323] Evidencë 161. Financimi i Projektit Laboratori i Doktoraturës

| | |
|---|---|
| objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | **Po.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron, infrastrukturën e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave laboratorike. Fakulteti i Biznesit ka dy laboratorë që janë në funksion të studentëve bachelor Bankë-Financë, me gjithsej 80 vende me një sipërfaqe 134.4 $m^2$. Laboratorët janë të pajisur me programe standarte por edhe specifike për plotësimin e nevojave të studentëve për studim dhe kërkim shkencor.[324] Programi për të cilin kemi aplikuar që të jetë i instaluar në të gjithë kompjuterët e laboratorit është programi i cili duhet të njihet nga çdo ekonomist i ardhshëm si Financa 5[325]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Standardi IV.3**<br>**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | **Po.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.<br>Në kuadër të pëmirësimit të cilësisë përdoren metoda të drejtpërdrejta, duke iu referuar rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[527] dhe Raportimin për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë për Institucionin[528] dhe raportin e vleresimit te brenshem per FB[529]. Në këto raporte përdoren metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. DKSC përmes sistemit të saj të informacionit mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. DKSC-ja bashkëpunon me strukturën përgjegjëse të institucionit për të dhënat statistikore që do të parashikonte një analizë sistemike të këtyre treguesve. Strukturat e ndryshme të SBSC-së kryejnë mbledhjen e të dhënave, në varësi të llojit të informacionit të kërkuar dhe analiza përcillet në NjBSC. Gjithashtu lektorët dorëzojnë në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme CV-të[530] dhe dosjet e tyre te vetëvleresimit[531] të cilat i disponojnë të gjithë përgjegjësit e departamenteve si dhe burimet njërëzore. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve vlerësohen nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore referuar shkresës së rektorit nr.900, prot. [532]. Në bazë të formularëve të raporteve çdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik, vlerësimi bëhet në bazë të formatit të vlerësimit i cili kalkulohet nga koordinatori i kërkimit shkencor[533][534] i cili është përzgjedhur me vendim departamenti. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të | **Po.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve[535], të atyre të diplomuar (alumni)[536], të personelit akademik[537], ndihmësakademik e administrativ[538], punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen |

[523] Evidencë 2. VKM nr. 685, datë 25.08.2010 "Për riorganizimin e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës"
[524] Evidencë 4. Raporti i Vlerësimit Institucional të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës 2016
[525] Evidencë 5. Vendimi nr 18, datë 24.03.2022 i Bordit të Akreditimit dhe Raporti i Vlerësimit Instuticional
[526] Evidencë 45. Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit
[527] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[528] Evidencë 4. Raporti i Vlerësimit Institucional të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës 2016
[529] Evidencë 45. Raport Vetëvlerësimi Fakulteti i Biznesit
[530] Evidencë 74. CV e stafit akademik të brendshëm
[531] Evidencë 73. Dosjet e vetëvlerësimit të lektorëve të Departamentit Financë-Kontabilitet
[532] Evidencë 174. Shkenca e Rektorit nr. 900, Njoftim për plotësimin e dosjes të vetëvlerësimit, NJK dhe NJB
[533] Evidencë 51. Vendimi i përcaktimit të kordinatorit të kërkimit shkencor
[534] Evidencë 52. Memo për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit
[535] Evidencë 62. Pyetësori i studentëve
[536] Evidencë 66. Info nga Alumni për punësimin pas studimeve
[537] Evidencë 62. Pyetësori i studentëve
[538] Evidencë 62. Pyetësori i studentëve

| | |
|---|---|
| tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.<br>Rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë ka përfshirja e studentëve në këtë proçes dhe i grupeve të tjera të interesit. Instrumentat e përdorura për metodën tërthortë (sondazhe, intervista) janë pasqyruar në nenet 6 dhe 15 të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NjSBC në çdo rast dokumenton dhe u bën të njohura Senati Akademik informacionin e nevojshëm mbi programin e studimit. Një prej instrumenteve për analizën e arritjeve të misionit institucional është përcaktimi i një grupi treguesish kyç të performancës (TKP)[539] referuar nenit 17 të Rregullores së NjSBC. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimeve që ofron UAMD-ja dhe strukturat e saj si NjSBC. Lista e TKP-së realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjSBC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik nga KPSC-ja. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | **Po.** UAMD ka parashikuar dhe garanton në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programeve të studimit[540]. UAMD i jep prioritet angazhimit të studentëve në cdo nivel të vendimarrjeve[541]. Përfaqësues të studentëve gjenden në çdo organ kolegjial duke filluar nga Senati Akademik e deri tek GVB[542] që ka hartuar këtë Raport të Vlerësimit të Brendshëm. Përfaqësimi i studentëve realizohet edhe në Bordin e Administrimit[543], përfaqësi e studentëve marrin pjesë edhe në mbledhjet e Dekanatit dhe Departamentit kur trajtohen çështje të lidhura me ta. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | **Po.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.<br>Përgjegjësitë dhe detyrat konkrete janë të përcaktuara në nenet të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[544] dhe në Rregulloren e Fakultetin e Biznesit UAMD[545] përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në takime dhe komisione si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë, nëpërmjet ngritjes së grupit të punës së vlerësimit të brendshëm[546]. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, | **Po.** Në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshihen studentët, lektorët, strukturat në nivel fakulteti, departamenti dhe në rang universiteti. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e Fakultetit të Biznesit (Dekanati), e departamentit Financë- |

[539] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[540] Evidencë 133. Pyetësor shpërndarë ekspertëve për përmiresimin e kurrikulave _BCH
[541] Evidencë 131. Përfshirja e Studentëve në Vendimarrje/Këshillim/Vlerësim vlerësimin mbi Procesin Akademik, UAMD
[542] Evidencë 63. Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e vetëvlerësimit të brendshëm
[543] Evidencë 162. Shkresë nga rektorati për përfshirjen e studentëve në organet vendimarrëse
[544] Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
[545] Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
[546] Evidencë 63. Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e vetëvlerësimit të brendshëm

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | Kontabilitet përgjegjës për programin e studimit Bachelor Bankë-Financë, në mbledhjet e mbajtura në departament si cilësia e syllabuseve, e literaturës së rë, e analizës së rregjistrimit të studentëve[547], e analizës së ecurisë së programit të studimit[548] dhe çdo problematike specifike gjatë një viti akademik. Lektorët kanë raportuar për mësimin online tek drejtuesi i njësisë bazë mbi procesin e mësimdhënies[549]. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | **Po.** Respektimi i standardeve akademike dhe integriteti akademik i personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në fakultet janë parime themelore për këtë institucion. Përzgjedhja e personelit për këtë proçes bazohet në kontributin, seriozitetin dhe integritetin akademik. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve, bazuar në Rregulloren e UAMD[550], Regulloren e Fakultetit të Biznesit[551] dhe Rregulloren e NJsBC[552]. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | **Po.** Referuar Ligjit për Arsimin e Lartë[553], referuar Manualit ASCAL[554] përfshihen si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, bashkëpunëtorë dhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit që japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | **Po.** Nëpërmjet web-it të UAMD, komunikimeve më email, takimeve informuese dhe publikimet në rrjetet sociale studentët informohen peridiokisht për organizimin, strategjitë, politikat, veprimtaritë dhe masat e marra për ecurinë dhe përmirësimin e cilësisë. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën | **Po.** Rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik, edhe publikohen për studentët dhe aktorët e tjerë, duke respektuar etikën akademike dhe legjislacionin për të dhënat personale[555]. UAMD në mënyrë periodike realizon takime dhe aktivitete me qëllim njohjen me rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit. Këto takime kanë formën e diskutimeve dhe |

547 Evidencë 77. Analiza vjetore e departamentit Finance Kontabilitet viti akademik 2018-2022
548 Evidencë 33. Studimi për tregun e punës pas daljes së studentëve
549 Evidencë 120. Relacion për zhvillimin e mësimit online
550 Evidencë 8. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës
551 Evidencë 22. Rregullore e Fakultetit të Biznesit
552 Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
553 Evidencë 20. Ligji nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
554 Evidencë 172. Manual ASCAL
555 Evidencë 87. Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43123
Web site: www.ascal.al
E-mail: info@ascal.al

| | |
|---|---|
| akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | bashkëbisedimeve mbi materialet finale të raporteve të vetëvlerësimit siç edhe është parashikuar në rregulloren e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë[556]. |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | **Po.** Fakulteti i Biznesit dhe njësia bazë e programit të studimit vihet në dijeni nga DSKC (NJSBC) mbi vlerësimin periodik të lektoreve me kohë të plotë dhe kohë të pjessshme, dhe për cdo rast specific diskutohet me lektorin e lëndës. Ky vlerësim ndikon në marrjen e masa në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme ndaj stafit akademik të angazhuar në programin e studimit[557]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | **Po.** Në mënyrë periodike, nga analizat e programit të studimit [558], Analiza e departamentit Financë-Kontabilitet[559] dhe Analiza e fakultetit të biznesit, vlerësohet ecuria e politikave dhe strategjive të ndjekura. Ata marrin masat e nevojshme për ndryshimet eventuale dhe përmirësime të mëtejshme. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit referuar Planit Strategjik[560][561]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | **Po.** Në mënyrë periodike fakulteti dhe departamenti organizojnë takime informuese për ndryshimet e ndodhura dhe përmirësimet e mëtejshme. Njëkohësisht, personeli është në dispozicion në ditë dhe në orare të ndryshme për studentët[562]. Objektiv kryesor ka qënë jo vetëm transparenca por edhe pjesëmarrja aktive e grupeve të interesit në politikbërjen dhe sugjerimet e marra në këto organizime. Ndër organizmet më të rëndësishme të mbajtura nga Fakulteti i Biznesit (UAMD) është Panairi i Punës[563], ku organizohet Forumi i Hapur me përfaqësuesit pjesëmarrës të bizneseve, ëorkshpe dhe leksione të hapura me ekspertë të fushave[564]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | ✓ |

556 Evidencë 13. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
557 Evidencë 62. Pyetësori i studentëve
558 Evidencë 33. Studimi për ecurinë e programit të studimit
559 Evidencë 77. Analiza vjetore e departamentit Finance Kontabilitet viti akademik 2018-2022
560 Evidencë 9. Plani i Zhvillimit Strategjik 2020 – 2025 të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
561 Evidencë 23. Plani strategjik i Departamentit Financë Kontabilitetit 2021-2025
562 Evidencë 147. Orari i konsultimeve
563 Evidencë 61. Panairi i Punës
564 Evidencë 138. Aktivitetet e Departamentit Financë Kontabilitet dhe aktivitetet në Fakultetin e Biznesit

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Bankë-Financë"**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. *Kurrikula* Në sajë të një kurrikule të përparuar e bashkëkohore teorike, metodike e praktike, do të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushën bankare dhe financiare që përmbushin nevojat e individëve dhe punëdhënësve, për tu mundësuar të diplomuarve karriera të shumëllojshme në tregun konkurrues të punës në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë në ndryshim dhe zhvillim.
2. *Kohëzgjatja e studimeve* Mundësia për të marrë diplomën bachelor për një periudhë 3 vjeçare duke marë njohuritë bazike dhe më tej të avancojnë në karrierën e tyre.
3. *Kalimi në programin e ciklit të dytë MSc/MP* Studentët e këtij programi mund të thellojnë studimet e tyre duke kaluar programin e ciklit të dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional në Bankë-Financë/ Master i Shkencave Financë-Kontabilitet, Master i Shkencave ISDR, të cilët ofrohen nga departamenti Financë-Kontabilitet.
4. *Kostot e studimeve* Përfitimet nga ky program janë shumë të larta krahasuar me kostot e tij. Tarifa e këtij programi është kosto e përballueshme për studentët.
5. *Program formues në profesionet e financës dhe bankës* Pothuajse të gjithë punëdhënësit kërkojnë minimalisht diplomë bachelor dhe vihet re që pasja e një diploma të tillë rrit shanset e punësimit, avancimit në karrierë dhe përfitimi i një page më të lartë.
6. *Nevojat e tregut të punës* Kërkesat për vende pune si bankier ose financier janë në çdo njoftim për vënde të lira pune (nga 2-3 vende të lira) të shpallura nga Zyrat e Punës ", ku pozicionin i financierit/ ndihmës ekonomist/ bankier zë një pjesë të mirë të vendeve të lira të punës.
7. *Qëndrueshmëria institucionale* Stabiliteti i Fakultetit të Biznesit dhe UAMD. Nga pikëpamja e organizimit, të potencialeve njerëzore dhe të potencialeve drejtuese, Fakulteti i Biznesit ka njohur vetëm ngritje. Kjo ka sjellë një qëndrueshmëri të strukturave të tij si të njësive bazë dhe atyre administrative, ashtu edhe të organeve kolegjiale. Fakulteti i Biznesit dhe departamentet e tij plotësojnë kriteret e vendosura nga Ligji i Arsimit të Lartë për organizimin strukturor të një Institucioni të Arsimit të Lartë.
8. *Konkurrencë e ndershme* Format demokratike të zgjedhjes të organeve kolegjiale dhe drejtuesve të njësisë kryesore dhe njësive bazë, forcimi i organeve kolegjiale, si dhe ndërgjegjësimi gjithnjë e më shumë për të sjellë në krye të drejtimit njerëzit me programet më të mira për zhvillimin e njësisë është një pikë e fortë që garanton një udhëheqje sa më kolegjiale të njësisë.
9. *Programi respekton Kuadrin ligjor dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve* Organizimi i studimeve në Fakultetin e Biznesit (cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë), në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë, mbyll ciklin e plotë të shkollimit të studentëve, duke përgatitur specialistë me kualifikime të ndryshme në fushat tona te studimit, nga niveli bachelor deri në nivelin e doktoraturës; rrit mundësitë e realizimit të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik; lehtëson kushtet e njohjes së diplomave tona në vendet e Bashkimit Europian.
10. *Staf akademik i kualifikuar dhe vital* Niveli i kualifikimit në rritje i stafit akademik efektiv është një pikë mjaft e fortë që garanton implementimin me sukses të programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimit. Cilësia dhe vitaliteti i personelit akademik dhe

administrativ, e siguruar përmes politikave dhe procedurave objektive të rekrutimit të tyre, duke siguruar punësimin e një personeli të përgatitur, cilësor dhe vital.

11. *Infrastruktura akomoduese* Ambjenti ku mundësohet mësimdhenia është konform me kërkesat bashkëkohore. Funksionimi i bibloteke-sallë leximi dhe këndi I studentit lehtëson përgatitjen e studentëve për detyrat që u kërkohen.
12. *Kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë* Sigurimi i cilësisë përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, hartimit të politikave të vlerësimit, përgatitjen e instrumentave, menaxhimin e procesit të vlerësimit, përgatitjen e raporteve, përfshirja e të gjithë aktorëve në këtë proces, etj.
13. *Klimë pozitive e punës dhe bashkëpunimit* Klima pozitive e bashkëpunimit midis stafit, administratës dhe studentëve. Respektimi i të drejtave të studentëve dhe vendosja e tyre në qendër të politikave dhe strategjive të zhvillimit të Fakultetit.
14. Organizim eficient i programit Menaxhimi efektiv i programit përmes ndarjes së ngarkesës mësimore, cilësisë së mësimdhënsies, vlerësimit të studentëve dhe pedagogëve, praktikës profesionale dhe temave të zhvilluara nga studentët, etj. Sistemi efektiv i regjistrimit dhe ruajtes së të dhënave për studentët, programet, pedagogët, etj.
15. *Interesi i lartë i tregut për programin* Programi Bachelor në Bankë-Financë është hartuar duke marrë për bazë nevojat e tregut për profesionistë në fushat e financës dhe bankës. Kurrikula e programit zhvillon njohuri dhe aftësi të cilat i përshtaten më së miri praktikave bashkëkohore të biznese, por është i dobishëm dhe për profesionistë në fusha të ngjashme.
16. *Bashkëpunimi institucional* Bashkëpunimi midis institucioneve të arsimit të lartë në vend dhe jashtë tij, përbën një mundësi për shkëmbim eksperience, ekspertize, informacioni, dijesh, teknologjish dhe burimesh njerëzore, por njëkohësisht ajo shërben edhe si një mundësi për reflektim e përmirësim të vazhdueshëm sidomos alternativat e aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore.
17. *Mundësi punësimi falë bashkëpunimeve UAMD-Biznese* Bashkëpunimi me biznese të ndryshme, sidomos në qytetin e Durrësit nxit rritjen e perfomancës së studentëve dhe rritjen e mundësisë për punësim të menjëhershëm pas diplomimit.
18. *Akreditimi* Një tregues i cilësisë së programit është akreditimi i tij. Një akreditim i shpejtë e bën konkurrues ndaj programeve të ngjashme me të.
19. *Mbështetja e vetë institucionit* Nga eksperienca në vite, UAMD-ja (Fakulteti I Biznesit) ka treguar vëmendje dhe mbështetje maksimale për programe të cilat kanë provuar të jenë vlerë e shtuar për institucionin.

***Pikat e dobëta:***

1. *Mungesa e disa linjave të transportit publik* Një numër i konsiderueshëm i studentëve të regjistruar në UAMD nuk janë banues në Durrës, por vijnë nga qytete/fshatra të ndryshëm. Kjo pengon ndjekjen e programit.

2. *Mungesa e konvikteve dhe mensave pranë Kampusit* Mungesa e një mense apo konvikti vështirësojnë jetën studentore.
3. *Konkurrenca e programeve paralele brenda Fakultetit* Ky program studimi ofrohet paralelisht me programe tjera profesionale brenda Fakultetit të Biznesit. Shpesh herë studentët janë të joshur nga lehtësia me të cilin merret programi sesa prespektiva e tyre në të ardhmen.
4. *Rënia e besueshmërisë mbi sistemin e arsimimit në vend* Studentët e diplomuar në programet bachelor dëshirojnë të vazhdojnë studimet jashtë vendit, të pasigurtë për dobinë e programeve që ofrohen në vend.

**Rekomandime:**

- Në plan afatmesëm rekomandohet ndërtimi i një konvikti per akomodimin e studentëve të cilët vijnë nga rrethet, apo i një mense ngrënie brenda ambienteve të Kampusit Universitar.

- Departamenti Financë-Kontabilitet duhet ti kushtojë vëmendje konkurencës që programi Bachelor në Bankë-Financë ka me programet e tjera të ofruara në Fakultetin e Biznesit por jo vetëm. Rritja e cilësisë së programit të studimit, kurrikulës dhe promovimi i programit Bch në Bankë- Financë duhet të jenë në fokus së punës të të gjithë institucionit dhe veçanërisht të departamentit Financë-Kontabilitet.

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Banking and Finance."**

**Strengths and Affirmations:**

1. ***Curriculum*** - Thanks to an advanced and contemporary theoretical, methodical, and practical curriculum, it will professionally prepare senior specialists in the banking and financial field that meet the needs of individuals and employers to enable graduates to have diverse careers in the competitive market of work following the demands and needs of the changing and developing society.

2. ***Duration of studies*** - The opportunity to obtain a bachelor's degree for three years, acquiring essential knowledge and further advancements in their career.

3. ***Transfer to the second cycle program MSc/MP*** - Students of this program can deepen their studies by passing the second cycle program Master of Science and Professional Master in Banking-Finance/ Master of Science in Finance-Accounting, Master of Science ISDR, which are also offered by the Finance and Accounting department.

4. ***Study costs*** - The benefits of this program are very high compared to its costs. The fee of this program is an affordable cost for students.

5. ***Formative program in the professions of finance and banking*** - Almost all employers require at least a diploma; it is noted that having such a diploma increases the chances of employment, career advancement, and the benefit of a higher salary.

6. ***Labor market needs*** - Requests for jobs as a banker or financier are in every vacancy announcement (from 2-3 vacancies) announced by the Labor Offices, where the position of financier/ assistant economist/ banker is a good part of the job vacancies.

7. ***Institutional stability*** - Stability of the Faculty of Business and UAMD. The Faculty of Business has only seen growth from the organization, human, and management potential point of view. This has brought about the stability of its structures, both the primary and administrative units and the collegial bodies. The Faculty of Business and its departments meet the criteria established by the Higher Education Law for the structural organization of a Higher Education Institution.

8. ***Fair competition*** - Democratic forms of the election of collegial bodies and leaders of the central unit and fundamental units, strengthening of collegial bodies, as well as increasing awareness to bring to the top of managing the people with the best programs for the development of the unit it is a strong point that guarantees the most collegial leadership of the unit.

9. ***The program respects the legal framework and the European and Albanian Framework of Qualifications*** - Programs Organization of studies in the Faculty of Business in full compliance with the Law on Higher Education, closes the complete cycle of student education, preparing specialists with different qualifications in our fields of study, from the bachelor's level to the doctorate level; increases the possibilities of realizing the mobility of students and academic staff; eases the conditions for the recognition of our diplomas in the countries of the European Union.

10. ***Qualified and vital academic staff*** - The growing qualification level of adequate academic staff is a strong point that guarantees the successful implementation of study programs in all study cycles. The quality and vitality of the academic and administrative staff are ensured through the policies and objective procedures of their recruitment, ensuring the employment of trained, qualified, and vital staff.

11. ***Accommodating infrastructure*** - The environment where teaching is possible conforms to contemporary requirements. The operation of the library reading room and the student's corner facilitates the preparation of students for the required tasks.

12. ***Continuous quality control*** - Quality assurance through the Internal Quality Assurance Unit, design of evaluation policies, preparation of instruments, management of the evaluation process, preparation of reports, involvement of all actors in this process, etc.

13. ***Positive climate of work and cooperation*** - Positive climate of cooperation between staff, administration, and students. Respecting students' rights and placing them at the center of the Faculty's development policies and strategies.

14. ***Efficient organization of the program*** - Effective program management through the teaching load division, teaching quality, assessment of students and lecturers, professional practice, and topics developed by students. Effective registration and data storage system for students, programs, lecturers, etc.

15. ***High market interest in the program*** - The Bachelor's Program in Banking-Finance has been designed based on market needs for professionals in the fields of finance and banking. The program's curriculum develops knowledge and skills best suited to contemporary business practices but is also helpful for professionals in similar fields.

16. ***Institutional cooperation*** - Cooperation between higher education institutions in the country and abroad is an opportunity to exchange experience, expertise, information, knowledge, technologies, and human resources. However, at the same time, it also serves as an opportunity for reflection and continuous improvement, especially application alternatives in national and international research projects.

17. ***Employment opportunities thanks to UAMD-Business collaborations*** - Collaboration with various businesses, especially in the city of Durrës, promotes increased student performance and the possibility of immediate employment after graduation.

18. ***Accreditation*** - An indicator of the program's quality is its accreditation. A quick accreditation makes it competitive with similar programs.

19. ***Support of the institution itself*** - From years of experience, UAMD (Faculty of Business) has shown maximum attention and support for programs that have proven to be added value for the institution.

**Recommendations:**

- In the medium term, building a dormitory to accommodate students who come from the districts or a canteen within the premises of the University Campus is recommended.
- The Finance-Accounting Department should pay attention to the competition the Bachelor in Banking-Finance program has with other programs offered in the Faculty of Business. The increase in the quality of the study program, the curriculum, and the promotion of the Bch program in Banking-Finance should be the focus of the entire institution's work, especially the Finance-Accounting department.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | ✓ |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR | | | | ✓ |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | ✓ |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | ✓ |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | ✓ |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR | | | | ✓ |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | ✓ |

**Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit**

Lista e mëposhtme është dokumentacioni i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë, por në një dokument mund të përmblidhen disa nga të dhënat e kërkuara. Në rastin e programeve të ciklit të dytë (Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë (Specializim Afatgjatë dhe Doktoratë) i gjithë ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqip dhe angleze ashtu si dhe RVB. Në cdo rast bazohuni në Manualin për "*Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit*"

1. Rregullore të përgjithshme dhe specifike të funksionimit të njësisë kryesore dhe bazë që ofrojnë

   Programin;

2. Dosja e programit të studimit e plotësuar me të gjitha elementët e nevojshëm;

3. Regullore e programit të studimit;

4. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin e studimit;

5. Strategjia e zhvillimit të programit;

6. Dëshmi e respektimit të autonomisë dhe lirisë akademike e financiare;

7. Politika të burimeve njerëzore, politikat e punësimit, përfshirë rekrutimin dhe përzgjedhjen;

8. Politika e zhvillimit të stafit akademik;

9. Struktura organizative e IAL dhe programeve;

10. Politika e jashtme për mobilitetin e stafit dhe studentëve;

11. Politika për të mësuarit, mësimdhënien dhe cilësinë në mësimdhënie;

12. Politika të vlerësimit akademik të stafit e mësimdhënies;

13. Rregulloret për testimet e provimet, kriteret dhe procedurat e diplomimit etj;

14. Diplomat dhe suplementet e diplomave;

15. Procedurë dhe ankimimi për studentët;

16. Procedurë për mbështetjen, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit;

17. Procedura për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies;

18. Politika e pranimit të studentëve;

19. Procedura e regjistrimit të studentëve, databaza e studentëve/regjistri;

20. Politika të mbështetjes, përkrahjes, u etj për studentët dhe struktura organizative të tyre;

21. Veprimtaria kërkimore, monitorimi dhe rezultatet në nivel programi;

22. Politika e bashkëpunimit dhe marrëveshjet e partneritetit në funksion të programit;

*Parathënie për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm*

**PARIMET E PUNËS SË GVB**

- Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.
- Zhvillimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në Njësitë e IAL.
- Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tabllo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve
- Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.
- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.
- Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.
- Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) të kryhet sipas formatit të hartuar nga ASCAL, duke mos bërë asnjë lloj ndryshimi (psh. Bashkim kriteresh, heqje kriteresh, etj.).

**ETAPAT E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Paraqitja e kërkesës së IAL për vlerësim dhe shqyrtimi i saj nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit.

- Miratimi i kërkesës dhe përcaktimi i afateve kohore të vlerësimit nga ASCAL dhe BA.
- Njoftohet zyrtarisht Koordinatori i IAL, për fillimin e procesit të akreditimit, dhe caktohet data e takimit me të për diskutimin e hapave të procesit.
- Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm; ky grup ngrihet nga titullari i njësisë;
- Trainimi i GVB nga stafi i ASCAL; për këtë vihen në dispozicion materialet udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat e përgjegjësitë e secilit.
- Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzuesit në fjalë (shih më tej). Gjatë kësaj faze GVB qëndron në kontakt të vazhdueshëm me ASCAL dhe asistohet nga kjo e fundit në rast kërkese;

- Përgatitja e Dosjes së Vetëvlerësimit (DVV);
- Dorëzimi zyrtarisht në ASCAL brenda afatit të përcaktuar (në versionin e printuar dhe elektronik CD, firmosur / vulosur nga IAL në çdo faqe), materialet të ngarkohen edhe në sistemin AMS të ASCAL.

## DOSJA E VETËVLERËSIMIT

Në përbërje të Dosjes së Vetëvlerësimit përfshihet: *Mendimi me shkrim i Drejtuesit të Njësisë* dhe *Raporti i Vlerësimit të Brendshëm,* i shkruar dhe firmosur nga secili anëtar i GVB.

Kërkohet mendimi i drejtuesit të Njësisë, kur Programi i studimit po kalon fazën e rivlerësimit periodik. Në këtë rast ai do të shkruajë:

- Të dhëna për Institucionin e Arsimit të Lartë që ai drejton;
- Të japë opinionet e veta personale ku të tregohen vlerat e forta, dobësitë dhe perspektiva e programit të studimit për të cilën është përgjegjës;
- Të analizojë zhvillimet kryesore që nga vlerësimi i fundit, duke theksuar sidomos përmbushjen e detyrave të lëna nga vlerësimet e mëparshme;
- Të tregojë gjendjen ekzistuese në raport me atë programi/et e studimit, ka për mision ose synon të arrijë.

## PËRMBAJTJA DOSJES SË VETËVLERËSIMIT

Dosja e Vlerësimit të Brendshëm në kuadër të vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit të programit të studimit duhet të përmbajë këto dokumente:

1. Mendimi me shkrim i Drejtuesit të IAL (Universitetit/Fakultetit);
2. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i firmosur nga të gjithë anëtarët e GVB. RVB përbëhet nga 6 fusha për programet e ciklit të parë Bachelor.
3. Çdo fushë duhet të analizojë kërkesat e standardid / kritereve, duke përfshirë pjesën përshkrimore dhe duke dhënë tregues të matshëm, bazuar në evidencat e dosjes së vetvlerësimit.
4. Bazuar në këtë analizë GVB duhet të përcaktojë vlerësimin përfundimtar të përmbushjes së standardeve të çdo fushe, dhe fushës në tërësi.
5. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm duhet të përmbajë edhe analizën përfundimtare të institucionit duke vënë në dukje pikat e forta dhe të dobëta të tij.